

THESARE

MJET FRYMËZIMI DHE UDHËRRËFYES PËR PASTORËT DHE SHËRBYESIT

numri 8 / verë 2016

Editorial 2

Gëzim Spahija

Adhurimi si Familje

Thelbi i Shtëpisë së Krishterë 3

Rob Rienow

Bekimi i Një Ati

Çfarë u Mëson Shkrimi Baballarëve

Për Rritjen e Fëmijëve 9

Mark Entzminger me Scott Harrup

8 Zakone të Martesave

të Perëndishme 16

Robert S. Paul

Sigurimi i Një Familjeje Frymërore

Për të Rriturit që janë Beqarë 22

Dennis Franck

Shërbesa Unike e Nënave 28

Marcia Lednicky

Përvijim Predikimi:

Prindërimi Biblik 34

Stephanie Plagenhoef



Tema e këtij numri:

Familja Moderne dhe Familja e Perëndisë



Familja Moderne dhe Familja e Perëndisë

Familja është institucioni më i lashtë i shoqërisë njerëzore. Krijimi nuk mund të ishte i plotë pa vendosjen e familjes në qendër, Adamit dhe Evës, një martesë e bekuar nga Perëndia, ku, me lindjen e fëmijëve, përveç privilegjit të riprodhimit, ata do të kishin përgjegjësinë e madhe të edukimit, për t'ia bërë të njohur Perëndinë fëmijëve.

Salomoni thekson: **“Mësoji fëmijës rrugën që duhet të ndjekë, dhe ai nuk do të largohet prej saj edhe kur të plakët”**. Termi “mësoji”, fjalë për fjalë do të thotë “ngulit” ose “të luftosh çdo ditë që ta sjellësh fëmijën në rrugë të drejtë, në rrugën e Shpëtimit”.

Për këtë misioni i familjes merr një rëndësi të veçantë, jo vetëm për prindërit dhe fëmijët e tyre, por për të gjithë familjen si një e tërë. Jezusi tha: **“Njeriu nuk rron vetëm me bukë, por nga çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë”**. Nëse familja është e themeluar mbi vlerat e Shkrimit të Shenjtë, bekimi i Perëndisë do të jetë mbi të dhe e ardhmja e saj do të jetë e garantuar.

Larg Perëndisë, njeriu vazhdimisht tërhiqet nga gjërat materiale, të dukshme dhe tokësore si push-teti, paraja, fama, suksesi, dhe karriera. Përpjekjet e tij për t'i arritur këto qëllime, përbëjnë të gjithë mundimin e tij për t'i përmbushur këto dëshira.

Paqja dhe harmonia me Perëndinë përfitohen përmes besimit në Jezus Krishtin, Shpëtimtarin e botës.

Shoqëria e sotme e fton njeriun që të jetojë një jetë të shthurur, të shfrenuar drejt kënaqësive egoiste.

Gënjeshtër, mashtrim, korrupsioni, fitimi i shpejtë e i pandershëm dhe mungesa e besnikëri-së bashkëshortore janë parime në rend të ditës. Besimtari nuk i pranon këto!

Si prindër, duhet të pranojmë realitetin se të mësuarit e fëmijëve është motivi i jetës sonë. Për këtë arsye, prindërit e krishterë duhet t'i mësojnë fëmijët e tyre se si të dallojnë atë që është e mirë dhe çfarë është e keqe, dhe për t'i kërkuar, më pas, forcë Perëndisë për të jetuar në bazë të asaj që Shkrimi mëson.

Udhëzuesi i vetëm dhe sjellja e drejtë gjendet në Bibël. Duhet të vazhdojmë përpara që të prindërojmë me dinjitet. Duhet t'i kushtojmë kohë, përkushtim dhe dashuri fëmijëve tanë. Duhet të jemi duke menduar sot çfarë qytetarësh po përgatisim për të nesërmen. Nëse fara që po mbjellim sot, është e shëndetshme, ne do të marrim frytet e saj nesër. Nëse po mbjellim mirë, do të korrim mirë.

Lutja dhe Fjala e Gjallë janë ushqimi bazë shpirtëror e i përditshëm i familjes, dhe e ftojnë Krishtin në shtëpi, si Zoti i mirëpritur që drejton jetën për çdo ditë. Familja e krishterë është një dëshmi e dukshme dhe e fuqishme e hirit shpëtues të Perëndisë.



GËZIM SPAHIJA

Drejtor Ekzekutiv, Këshilli i
Përgjithshëm i Asambleve të
Perëndisë të Shqipërisë.

THESARE

Numri 8
Verë 2016

Koordinatorë e projektit: Stephanie Plagenhoef
Përkthyes: Fabian Tozharaku
Redaktues: Skënder Hoxha
Grafika kompjuterike: Lindita Sqapi

Botuar nga:
Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë
të Shqipërisë

Në bashkëpunim me:
Life Publishers International

Adresa: K.P. 119 / Kutia 2 / Tirana, Albania
Cel: (+355) 69-406-8956
Email: KTU@icc-al.org



Artikujt e zgjedhur dhe grafika përshtatur nga revista Enrichment - ©Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, ShBA. Përdorur me leje.

©Life Publishers International. Të gjitha të drejtat të rezervuara.



ADHURIMI SI
FAMILJE:
The Ibi
I SHTËPISË SË
KRISHTERË

Nga: ROB RIENOW



Thelbi i një shërbese familjare sipas Biblës nuk është më shumë trajnim frymëror në kishë, por më tepër trajnim frymëror brenda çdo shtëpie të krishterë.

n

ë verën e vitit 2004, Perëndia më solli në një pikë thyerjeje. Kisha 10 vjet që shërbeja si pastor i të rinjve. Po kaq kohë kishim të martuar bashkë me Emin, dhe Perëndia na kishte bekuar me katër fëmijë. Problemi ishte se zemrën e kisha në punë, jo në shtëpi. Pasioni im ishte që t'i bëja dishepuj fëmijët dhe të rinjtë e kishës sonë. Por nuk kisha asnjë vizion dhe asnjë plan se si të dishepullizoja fëmijët e mi. Në kishë isha një udhëheqës frymëror, ndërsa në shtëpi isha pasiv. Perëndia më solli në pendim dhe ma ktheu zemrën drejt shërbesës sime më të rëndësishme: ta udhëhiqja familjen time për ta dashur dhe për ta ndjekur Perëndinë.





Materiale për Adhurimin Familjar

Shkarkoni falas
udhëzuesit e
adhurimit familjar
për prindërit dhe
gjyshërit në kishën
tuaj në faqen
www.visionarnam.com/downloads/.

Kisha përballlet me një krizë. Bota po na merr pjesën më të madhe të fëmijëve tanë. Sipas një sërë studimesh, rreth 60 - 80 për qind të fëmijëve që rriten në kishat tona sot, po largohen nga besimi kur bëhen më të rritur.¹ Po si ka mundësi që ka ndodhur kjo?

Për një pjesë të mirë të besimtarëve, reagimi i parë ndaj kësaj krize është një nxitje urgjente për të përmirësuar shërbesën e fëmijëve dhe të të rinjve. Por në të vërtetë, problemi themelor nuk është kisha, përkundrazi, është familja e krishterë. Deri në fillim të shekullit të 20-të, njerëzit në përgjithësi mendonin se trajnimi frymëror i fëmijëve ishte përgjegjësia e prindër-ve dhe e gjyshërve që në shtëpi.

DASHURIA NDAJ PERËNDISË FILLON NË SHËTËPI

Tek Mateu 22, Jezusi nxori në pah urdhërimin më të rëndësishëm të Biblës: “Ti do ta duash, pra, Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemër, me gjithë shpirt dhe me tërë forcën tënde. Dhe këto fjalë që sot po të urdhëroj, do të mbeten në zemrën tënde; do t’ua ngulitësh bijve të tu, do të flasësh për to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur ke rënë në shtrat dhe kur çohesh”. (Ligji i Përtërirë 6:5 - 7).

Menjëherë pas Urdhërimit të Madh, Perëndia na e drejtoi vëmendjen tek jeta familjare. Në veçanti, ai u foli prindërve që ta jetonin dashurinë që kishin për Të duke bërë gjithçka që ishte në dorën e tyre për t’ua transmetuar besimin fëmijëve të tyre. A e kemi seriozisht dashurinë tonë për Perëndinë? Atëherë duhet ta kemi seriozisht edhe edukimin me zell të fëmijëve tanë rreth fjalës së Perëndisë. Ky është misioni i parë që Perëndia na dha mbas urdhërimit më të rëndësishëm të Biblës. Ky është qëllimi i prindërimit dhe i “gjyshërimit”: që të ngulisim në zemrat e fëmijëve tanë dashurinë për Perëndinë. Në thelb të Urdhërimit të Madh qëndron dishepullizimi në familje, ku prindërit janë trajnerët frymërorë parësorë të fëmijëve të tyre.

ADHURIMI FAMILJAR NË HISTORI

Gjatë viteve 1600, udhëheqësit e kishës vizitonin rregullisht shtëpitë e secilës familje nga kisha për të vlerësuar nëse prindërit po i dishepullizonin ose jo fëmijët e tyre përmes praktikës sistematike të adhurimit familjar. Në vitin 1647, besimtarët në Skoci publikuan *Udhëzuesin e Adhurimit Familjar*, në të cilin ata shkruan: “Asambleja kërkon dhe përcakton

shërbenjës për të bërë kërkime dhe hetime të kujdesshme, për të parë nëse ka midis tyre një ose disa familje të cilat e neglizhojnë detyrën e adhurimit familjar. Nëse gjendet një familje e tillë, kreu i kësaj familjeje duhet të paralajmërohet privatisht për të ndrequr gabimin e tij; dhe në rast se vazhdon ashtu, atëherë duhet të qortohet ashpërsisht nga njerëzit e mbledhur; dhe mbas këtij qortimi, nëse ai gjendet ende duke e neglizhuar adhurimin familjar, atëherë për shkak të kokëfortësisë së tij, lëreni në këtë ofendim, të pezulluar dhe të ndaluar nga marrja e Darkës së Zotit, derisa ai të ndreqet”.

Adhurimi familjar ishte një çështje madhore e disiplinës kishtare. Përse e kishin marrë kaq seriozisht këto kisha? Përse investuan ka shumë kohë duke shkuar shtëpi më shtëpi për të inkurajuar dhe për t’u siguruar që adhurimi familjar po kryhej siç duhej? Adhurimi familjar ishte një prioritet parësor për shkak se kishat ishin të zjarrta për të zbatuar Porosinë e Madhe. Më shumë se çdo gjë tjetër, ata donin të shihnin që ungjilli i Krishtit të përparonte në nivel vendor dhe global. Ata e dinin se Porosia e Madhe për të bërë dishepuj fillonte me bijtë dhe bijat e tyre. Ata e dinin se Perëndia kishte folur qartë në Bibël që prindërit dhe gjyshërit ishin ata që duhej të merrnin drejtimin e trajnimit frymëror të fëmijëve dhe nipërve e mbesave të tyre. Për ta, një kishë nuk mund të ishte serioze në zbatimin e Porosisë së Madhe nëse nuk ishte serioze në adhurimin familjar.

Në fund të viteve 1800, Çarls Spërzhën (Charles Spurgeon) ishte tejet i shqetësuar rreth ndryshimeve që po ndodhnin në kulturën e krishterë. Ai pa një numër në rritje prindërisht që po ia delegonin trajnimin frymëror të fëmijëve të tyre kishës, në vend që ta merrnin vetë drejtimin në shtëpi. Në artikullin e tij: “Lloji i rizgjimit për të cilin kemi nevojë” (The Kind of Revival We Need), ai shkroi: “Ne kemi shumë dëshirë për një rizgjim të një besimi ku të përfshihet e gjithë familja. Familja e krishterë ishte mburoja e perëndishmërisë në kohët e puritanëve, por në këto kohë të liga, me qindra familje të ashtuquajtura të krishtera nuk kanë aspak adhurim familjar, asnjë kontroll mbi rritjen e bijve dhe asnjë udhëzim apo disiplinë të shëndetshme. Si mund të shpresojmë që të shohim përparimin e mbretërisë së Zotit tonë kur vetë dishepujt e Tij nuk ua mësojnë ungjillin e Tij bijve të tyre? O burra dhe gra të krishterë, mos u bëni sipërfaqësorë, por çojeni deri në fund atë që bëni, atë që njihni dhe që mësoni. Le të trajnohen familjet tuaja në frikën e Perëndisë dhe ju vetë të bëheni “të shenjtëruar ndaj Zotit”. Dhe kështu do të qëndroni si një shkëmb në mesin e valëve të fryra të gabimit dhe të paperëndishmërisë, të cilat shkumëzojnë rreth e rrotull nesh”.

Mesazhi i Spërzhën është jashtëzakonisht i nevojshëm sot. Burra dhe gra të perëndishëm nëpër kishat në rritje marrin thirrjen e vazhdueshme për t’u përfshirë në shërbesë. Shpeshherë shërbesa është

sinonim i “daljes vullnetar për të marrë pjesë në një program të kishës”. Për hir të brezave të ardhshëm, na duhet të kthehemi tek vizioni biblik që thotë se shërbesa fillon në shtëpitë tona.

Adhurimi familjar është diçka e rrallë sot në shtëpitë e krishtera. Gjatë konferencave për familje që bëjnë nëpër kisha, i pyes rregullisht pjesëmarrësit se sa prej tyre janë rritur në një shtëpi ku praktikonin një lloj adhurimi familjar apo devocioni (kohë e qetë) familjar. Përgjigja është e njëjtë: 10 deri në 15 për qind të të rriturve të krishterë në kishat tona sot kanë përjetuar adhurim familjar kur po rriteshin. Në një anketim shkencor, Xhorxh Barna zbuloi se “më pak se një e dymbëdhjeta e familjeve që shkojnë në kishë, e adhurojnë Perëndinë diku tjetër përveç shërbesës së kishës, ose kanë ndonjë studim të rregullt Bible apo ndonjë kohë të qetë së bashku gjatë një jave tipike”.²

ÇFARË MUND TË BËJNË PRINDËRIT?

Shumë zakone dhe praktika mund ta pasurojnë dhe forcojnë familjen tuaj nga ana frymërore. Hani vaktet së bashku. Shërbejini fqinjëve tuaj. Dilni së bashku vullnetarë në kishë. Merrni pjesë në udhëtime misioni afatshkurtra që janë për familje. Por këto janë si kremi mbi tortë. Me qëllim që kremi të qëndrojë, si fillim do t’ju duhet të bëni tortën. Është një praktikë ajo që e formon themelin thelbësor për shtëpinë e krishterë. “Do të flasësh për to kur rri ulur në shtëpinë tënde” (Ligji i Përtërirë 6:7).

Perëndia i thërret krerët e shtëpive që t’i mbledhin familjet së bashku në ambientin familjar, për atë që historia e krishterë e quan adhurim familjar. “Do të flasësh për to [Fjalën e Perëndisë] kur rri ulur në shtëpinë tënde” (theksi i imi). Adhurimi familjar është koha kur familja mbledhet për lutje, lexim të Biblës dhe për bashkëbisedim frymëror. Familjet hanë ushqim fizik së bashku për të ushqyer trupat e tyre. Ndërkohë që adhurimi familjar është një vakt frymëror për të ushqyer shpirtat e tyre.

Në vitin 2004, u përballa me realitetin që orari im i punës nuk e lejonte adhurimin e rregullt familjar në shtëpinë time. Ky udhëzim i qartë nga Perëndia më bindi që orari ditor që kisha zgjedhur po më çonte në mëkat dhe po më parandalonte nga praktikimi i të parës gjë specifike që Perëndia më kishte kërkuar si reagim ndaj urdhërimit më të madh nga të gjitha urdhërimet e Tij.

ADHURIMI FAMILJAR

Shumë prej familjeve tuaja mund ta shohin nevojën për të pasur adhurim familjar, por nuk dinë se si ta bëjnë. Ndërsa këto familje rriten në praktikën e adhurimit familjar, le të marrin në konsideratë përdorimin e përzier të këtyre pesë elementeve.

1. *Aktiviteti.* Disa nga kohët më të mira të adhurimit familjar në shtëpinë tonë janë ato kohë kur ne i bashkojmë energjitë tona për të përgatitur një aktivitet të vogël që na ndihmon t’i futemi në brendësi leximit të Biblës. Ky lloj ushtrimi është veçanërisht i dobishëm për fëmijët. Ne shpesh luajmë një lojë me pjesë nga Bibla, ku dikush aktron një nga historitë e Biblës ndërkohë që të tjerët përpiqen të gjejnë se për cilën histori bëhet fjalë. Kërkoni për të gjetur mësim të thjeshta me objekte, të cilat shpjegojnë parime frymërore. Në qoftë se familjet kanë fëmijë të moshave të ndryshme, sugjeroni që t’i kërkojnë fëmijëve të tyre më të mëdhenj që të planifikojnë një aktivitet për ata më të vegjlit.

2. *Këndimi.* Kur ne këndojmë, i afrohem Perëndisë dhe njëri-tjetrit. Nuk është e thënë të jemi të talentuar nga ana muzikore. Vendosi një disk me këngë adhurimi dhe këndoni bashkë me to. Nëse filloni të këndoni bashkë me fëmijët tuaj kur ata janë të vegjël, do të rriteni në një familje e cila do të këndojë së bashku për shumë breza të tërë.

3. *Leximi i Biblës.* Ky është thelbi i adhurimit familjar. Ajo për të cilën fëmijët tuaj kanë nevojë më shumë se çdo gjë tjetër është që t’ju shohin juve të hapni

KISHA JUAJ MUND T’I PAJISE FAMILJET

Më poshtë do të gjeni disa mënyra praktike se si kisha juaj mund t’i inkurajojë dhe pajisë prindërit për t’i dishepullizuar fëmijët e tyre në shtëpi me anë të adhurimit familjar:

Pajisini prindërit me tekstin kryesor të predikimit të së dielës së ardhshme, së bashku me një këngë adhurimi të cilën do ta këndoni gjatë shërbesës së javës së ardhshme. Inkurajoni çdo familje që gjatë javës ta lexojnë atë pjesë nga Bibla dhe ta këndojnë atë këngë së bashku në shtëpi. Jo vetëm që kjo do të inkurajojë më shumë adhurim familjar, por do të përshpejtojë dhe do të nxisë, nga ana frymërore, mendjet dhe zemrat e fëmijëve dhe të të rriturve për shërbesën e ardhshme. Fëmijët

që përjetojnë adhurim familjar në shtëpi trajnohen dhe pajisen që të angazhohen në adhurim të përbashkët në kishë. Ju mund të filloni që të krijoni një kulturë dishepullizimi familjar në kishën tuaj, duke iu treguar prindërve se çfarë do të ndodhë javën tjetër dhe duke iu kërkuar atyre të marrin drejtimin për leximin e pjesës kyçe nga Bibla dhe për t’u lutur me fëmijët e tyre në shtëpi.

A ka në kishën tuaj klasa mësimi për të rriturit apo grupe të vogla? Po sikur ato takimet e dishepullizimit për të rriturit të mbylleshin nga drejtuesi me fjalët: “Dua t’ju jap sfidën e parë të gjithëve ju. Merrni Shkrimin që studiuam sot, si edhe atë që ju mësuat nga Shkrimi, dhe ua tregoni në shtëpi fëmijëve tuaj, nipërve dhe mbesave tuaja”.

Thelbi i një shërbese familjare sipas Biblës nuk është më shumë trajnim frymëror në kishë, por më tepër trajnim frymëror brenda çdo shtëpie të krishterë. Nëse i pajisni shtëpitë e kishës suaj që të mbushen me një adhurim familjar të rregullt, besnik dhe të vërtetë, atëherë do ta shihni ungjillin që të përparojë për breza të tërë.

librin e Perëndisë dhe ta lexoni atë me një zemër të mbushur me besim. Do të ketë ditë që ju thjesht mund të lexoni vetëm një fjalë të urtë. Herë të tjera mund të lexoni disa kapituj nga njëri prej ungjijve. Fjala e Perëndisë është e gjallë dhe aktive (Heb. 4:12). Fjala e Perëndisë është e aftë të na bëjë të urtë për shpëtim (2 Timoteut 3:15). Armiku do të bëjë gjithçka që mundet për ta penguar familjen tuaj nga leximi së bashku i Biblës. Aty gjendet fuqia për t'i transformuar zemrat tuaja dhe për t'i ripërtërirë mendjet tuaja.

4. Diskutimi. Flisni rreth asaj që lexoni në Shkrim. Çfarë të vërtetash mësuat nga Fjala e Perëndisë? Si zbatohet kjo e vërtetë në jetën tuaj? Disa prindër i frikësohen faktit se fëmijët e tyre do t'iu bëjnë pyetje për të cilat ata nuk i dinë përgjigjet. Mos u shqetësoni. I inkurajoni të gjitha llojet e pyetjeve. Çojini ato pyetje tek pastori juaj. Çojini ato përpara Zotit në lutje.

5. Lutja. Pjesa ime e preferuar e ditës është kur familja jonë me gjashtë anëtarë ulet në gjunjë rreth e rrotull tavolinës sonë të mesit (tavolinës sonë të lutjes). Rrëfejme mëkatet tona. E falenderojmë Perëndinë për mirësinë dhe për besnikërinë e Tij. Lutemi për ata persona të cilët janë të sëmurë dhe po vuajnë. Lutemi për ata të cilët janë të humbur, që të pendohen dhe t'i besojnë Krishtit. Lutemi që Perëndia ta përdorë familjen tonë dhe kishën tonë në të gjithë botën për lavdinë e Tij.

Merrni në konsideratë që të përdorni një metodë lutjeje, e cila mund ta lejojë secilin person në familje që t'iu tregojë të tjerëve një pikë kulmore të ditës së tyre. Pasi personi ka mbaruar atë që kishte për të thënë, kërkojini dikujt që të lutet dhe të falenderojë Perëndinë për ato gjëra të mira. Pastaj ftoni secilin që të tregojë pikën më të ulët të ditës që ka kaluar. Cila ishte gjëja më e vështirë me të cilën u përballën ata? Pasi secili ka thënë atë që kishte në zemër, kërkojini dikujt që të lutet dhe t'i ngrejë ato gjëra të vështira tek Zoti, duke kërkuar forcën e Tij dhe hirin që vetëm Ai mund të na japë për t'u përballur me çdonjërin prej tyre.

THJESHT FILLONI

Inkurajojini prindërit që të mos presin për të filluar adhurimin familjar në shtëpitë e tyre deri kur të bëhen të krishterë më të mirë. Prindërit nuk duhet të presin deri në kohën kur axhenda e tyre të jetë më pak kaotike ose kur fëmijët e tyre të jenë pak më të mëdhenj. Inkurajojini që të marrin masa për të rritur lutjen dhe leximin e Shkrimit në shtëpitë e tyre.



ROB REINOW, D.Min., nga Wheaton, Illinois, shërben si themelues i Shërbesave të Familjes Vizionare dhe si një nga pastorët në kishën Gospel Fellowship Church. Ai është autor i gjashtë librave, duke përfshirë këtu *Visionary Parenting (Prindërim Vizionar)*, dhe *Unlimited Kingdom: Uniting Church and Family in the Great Commission (Mbretëri e Pakufizuar: Duke Bashkuar Kishën dhe Familjen në Porosinë e Madhe)*.

Ndryshimi i vërtetë fillon me një pendim të vërtetë. Nëse prindërit nuk i kanë udhëhequr në aspektin frymëror familjet e tyre dhe fëmijët që iu janë besuar nga Perëndia, inkurajojini që ata t'ia rrëfejnë këtë gjë Zotit dhe të marrin faljen e Tij përmes Krishtit. Le t'i kërkojnë Perëndisë që t'ua kthejë zemrat për nga shërbesa e fëmijëve të tyre. Udhëzojini që ata t'i kërkojnë Perëndisë që misioni numër një në jetë të bëhet vulosja e zemrave të fëmijëve të tyre plot me një dashuri për Perëndinë.

Gjithashtu inkurajojini që t'iu rrëfehen familjeve të tyre. Tregojini se si Perëndia i ka bindur dhe i ka thirrur që të rriten në praktikën e adhurimit familjar. Ndani me ta frikërat dhe ankthet tuaja. Ftojini që t'ju ndjekin juve, ndërsa ju kërkonin të ndiqni Krishtin.

TRAMPOLINA E HEDHJES PËR FAMILJEN TUAJ

Perëndia dëshiron që ta përdorë kohën e adhurimit familjar si një trampolinë kërcimi nga ku familjet do të ndikojnë botën për Krishtin. Kur prindërit i vendosin gjërat e rëndësishme në fillim, në shtëpitë e tyre, Perëndia do t'ua transformojë zemrat dhe ata, gjithnjë e më shumë:

- do të marrin masa për të arritur fqinjët e tyre, të cilët kanë nevojë për lutje, mbështetje, shpëtim.
- do të ndajnë zemrat e tyre me njëri-tjetrin gjatë kohës së konsumimit të vakteve.
- do t'ua japin paratë e tyre personave që janë në nevojë dhe çështjeve në të cilat ata besojnë, në vend që t'ia japin diçkaje që është më popullore.
- do të shpenzojnë më shumë kohë duke ndihmuar dhe duke bekuar gjyshërit.
- do të përdorin një pjesë të kohës së tyre të pushimeve për të shërbyer dhe për mision.
- do të falin njëri-tjetrin, në vend që të ziejnë nga inati.

Ekzistojnë qindra mënyra se si Perëndia mund t'i përdorë familjet për të ndërtuar mbretërinë e Tij. Por nuk mund t'i marrim gjërat e rëndësishme duke i vendosur ato në plan të dytë. Thirrja e parë e Perëndisë për familjet është që ta adhurojnë Atë së bashku. Ndërsa familjet, gjithnjë e më shumë, e adhurojnë Perëndinë në shtëpi, Ai do t'i bekojë ata për breza e breza të tërë.

Shënime

1. Rob Rienow, *When They Turn Away (Grand Rapids: Kregel Publications, 2011)*.
2. George Barna, *Transforming Children Into Spiritual Champions (Ventura, California: Regal, 2003), 125*.

DUKE NDJEKUR KËTO PARIME BIBLIKE,
ETËRIT E SOTËM MUND T'JU SHPALLIN
FJALË BEKIMI JETËVE TË FËMIJËVE TË TYRE
DHE TË SHOHIN REZULTATE ME
DOMETHËNIE TË PËRJETSHME.

BEKIMI

i


Një Ati

Çfarë u Mëson Shkrimi Baballarëve
për Rritjen e Fëmijëve

Nga: MARK ENTZMINGER

me: SCOTT HARRUP





Si rrëfhet në një nga tregimet familjare më prekëse të Shkrimit, patriarku Jakob (i njohur gjithashtu me emrin Izrael) është në Egjipt duke vdekur, pas një jete të trazuar që zgjati mbi një shekull.

Ai i mbledh bijtë e tij rreth shtratit të vdekjes dhe shpall fjalë bekimi mbi jetët e tyre (Zanafilla 49:1-28). Fjalët e tij janë të çiltra; ato shpallin edhe bekimin e Perëndisë, por edhe, në disa raste, disiplinën e Tij: “I bekoi duke i dhënë secilit një bekim të veçantë” (vargu 28).

Libri i Zanafillës paraqet në mënyrë të sinqertë dinamikën e familjes brenda klaneve të formuara nga kombi i zgjedhur i Perëndisë. Spektri i vlerësimit atëror nga Jakobi reflektonte dekada të tëra vëzhgimi të momenteve kyçe në jetën e secilit prej bijve të tij, si ato të lavdërueshmet, edhe ato të turpshmet. Vetë intriga dredharake e Jakobit i zhvati Esaut, vëllait të tij, bekimin e Isakut, atit të tyre. Si Isaku, ashtu edhe Abrahami para tij, jetuan si burra të besimit mbi këmbë prej balte.

Por ky tregim nga Zanafilla i drejton etërit e sotëm drejt një të vërtete të mrekullueshme: Baballarët që nderojnë Perëndinë mund të kthehen në kanale të ndikimit hyjnor jetëndryshues në jetët e fëmijëve të tyre. Zanafilla shërben si e çara e vogël në derën e madhe biblike drejt një atësie plot ndikim të drejtuar nga Perëndia. Po ashtu si Jakobi, edhe etërit e sotëm mund t’iu shpallin fjalë bekimi jetëve të fëmijëve të tyre dhe të shohin rezultate me domethënie të përjetshme.

Ai bekim shkon përtej fjalëve, madje edhe fjalëve me lutje. Ai bekim përmbledh gjithçka që një njeri është dhe prek gjithçka që një djalë apo vajzë do të bëhet.

PRANIA

Kultura jonë e kohëve moderne mund ta mashtrojë dikë që është baba që të besojë se prania e tij mund të jetë virtuale dhe njëkohësisht jetëformuese për bijtë e tij. Por tuitat, mesenxherët dhe pëlqimet e fejsbukut nuk do të munden kurrë që ta zëvendësojnë lidhjen prej mishi e gjaku që Perëndia paracaktoi mes baballarëve dhe fëmijëve. Merrni në konsideratë Ligjin e Përtërirë 6:6, 7: “Dhe këto fjalë që sot po të urdhëroj, do të mbeten në zemrën tënde; do t’ua ngulitësh bijve të tu, do të flasësh për to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur ke rënë në shtrat dhe kur çohesh”.

Çdo pikë në këto fjali flet për një lidhje personale, dhe tabloja e plotë ka të bëjë me një ndërveprim gjatë gjithë ditës. Patjetër, karrierat dhe oraret e shkollës, si edhe marrëdhëniet me familjen më të gjerë kërkojnë vendin e tyre në ditën tonë, por kur qëllimi ynë është që, në çdo mundësi që na jepet, të kalojmë kohë personalisht me fëmijët tanë, atëherë këto mundësi shumëfishohen.

Një numër i madh prindërisht kërkojnë që ta vënë këtë fragment në zbatim përmes një copëzimi të rremë të ditës së tyre: “Të paktën kalojmë pak kohë në mëngjes, dhe të paktën bëjmë diçka kur hamë bashkë ...”.

Kjo është një pikë e mirë fillimi, por mësoni ta zhvilloni këtë gjë në të gjitha aspektet e jetës suaj. Ligji i Përtërirë na paraqet një tablo ku fëmijët e vëzhgojnë prindin në çdo hap që hedhin – që kur ngriheni në mëngjes e deri në darkë kur bini në shtrat.

Duke qenë se fëmijët janë imitues, ne duhet ta jetojmë Fjalën. Duhet ta jetojmë besimin tonë me zë të lartë, në mënyrë që fëmijët tanë ta marrin atë. Nuk bëhet fjalë që kur të jemi në makinë apo në shtëpi së bashku, duhet të sigurohemi që të kemi patjetër biseda rreth Biblës. Përkundrazi, kur jam në makinë dhe ndodh diçka, më duhet të sigurohem që besimi im dhe Fjala e Perëndisë të jenë tek unë, në atë pikë që, qoftë në biseda apo në raste urgjence, ato të dalin prej meje.

Herën e parë kur do ta dëgjoni veten tek fjalët e fëmijëve tuaj, ndërkohë që thonë të njëjtat gjëra që ju thonë, me siguri do të tronditeni dhe të mbushur me habi do të thoni: “S’më merrte mendja që e kishte dëgjuar atë fjalë”.

Por Ligji i Përtërirë ngul këmbë se nuk duhet të çuditeni asnjëherë nga imitimi i fëmijëve tuaj. Sepse ata po ju vëzhgojnë gjatë gjithë kohës, pavarësisht nëse jeni të qëllimshëm apo jo në ato që bëni. Me fjalë të tjera, Ligji i Përtërirë po thotë: Jini të qëllimshëm (pra, për t’i bërë gjërat duke e ditur që po vëzhgoheni), dhe lëreni besimin tuaj të dalë natyrshëm prej jush.

MODELIMI

“Ai ka vendosur një dëshmi te Jakobi dhe ka vënë një ligj në Izrael, dhe ka urdhëruar etërit tanë që t’ua bëjnë të njohura bijve të tyre, me qëllim që brezi i ardhshëm t’i njohë së bashku me bijtë që do të lindin; dhe këta nga ana e tyre t’ua tregojnë bijve të tyre, dhe të vendosin te Perëndia besimin e tyre dhe të mos harrojnë veprat e Perëndisë, por të respektojnë urdhërimet e tij” (Psalmi 78:5–7).

Cilat ishin në fakt “statutet” që Perëndia dekretoi për popullin e Tij? Në qoftë se shohim përtej kërkesave të sistemit sakrifikes të adhurimit, atëherë këto statute ishin detaje të jetës së përditshme. Pra, prindërit, me qëllim që t’ia mësonin me të vërtetë

ligjin e Perëndisë brezit të ri, duhet t'i vinin vetë veshin kërkesave ose pikave të Ligjit gjatë punës dhe pushimit të tyre të përditshëm.

Baballarët duhet të jetojnë në atë mënyrë që fëmijët të rriten duke njohur Perëndinë dhe të thithin gjithçka që Perëndia ka për ta. Kjo nuk ka asnjë lidhje me legalizmin apo me përvetësimin abuziv të së drejtës, por ka të bëjë me një fokus që Dhjata e Re i jep jetesës sipas shembullit të Jezusit dhe drejtimit, me anë të shembullit tonë, të fëmijëve tanë tek Ai. Duke e bërë këtë gjë, ne krijojmë një zinxhir nga njëri brez në tjetrin të një jetese të perëndishme.

Kolbi, djali ynë më i madh, e ka kapur siç duhet këtë koncept. Ai kërkon të bëhet shok me djem të cilët nuk kanë një besim të fortë ose nuk kanë një jetë të mirë familjare, dhe ne lutemi rregullisht për ta bashkë

me Kolbin. Një nga shokët e tij të shkollës po rritej pa njohurinë e Perëndisë, dhe kur Kolbi i dha shokut të tij një Bibël, prindërit e shokut të tij e detyruan atë që t'ia kthente Biblën. Ishte një mësim i vrazhdë, por i thjeshtë mbi ndikimin që edhe fëmijët tanë mund të kenë për Krishtin.

Jam i privilegjuar që të shërbej sot në kishë nëpërmjet ndikimit të tre brezave në Asamblenë e Perëndisë që kanë kaluar përpara meje. Stërgjyshërit e mi dhanë ndihmën e tyre për fillimin e kishës ku unë u rrita: Asambleja e Parë e Perëndisë, në qytetin Xhejmstaun, North Dakota. Gjyshja ime ishte një nga mësueset e para të shkollës së të dielës. Ajo dha mësim në shkollën fillore për më shumë se 60 vjet. Prindërit e mi u takuan në Institutin e Biblës Triniti, dhe babai im ishte pastor në një kishë gjermane për

Fjala e Perëndisë dhe djali juaj

“Dhe ju, etër, mos provokoni për zemërim fëmijët tuaj, por i rrisni në disiplinë dhe në këshillë të Zotit”. (Efesianëve 6:4).

Shumë parime biblike i lidhin të dyja gjinitë me prindërimin, por këtu është një element që është i përshtatshëm veçanërisht për etërit ndërsa merren me bijtë e tyre. Është shumë e lehtë që shpirti konkurrues i mashkullit ta gërryëjë gjykimin e mirë të një babai në lidhje me një djalosh që po bëhet burrë. Baballarët mund të ‘zihen’ me shaka me fëmijët, por nuk duhet të bëjnë kurrë ‘të fortin’ me ta, qoftë emocionalisht, qoftë fizikisht.

“Dy fëmijët u rritën dhe Esau u bë një gjahtar i sprovuar, një njeri i fushës, ndërsa Jakobi ishte një njeri i qetë, që jetonte në çadra”. (Zanafilla 25:27).

Ja një depërtim njohurie shumë i mirë për botën e sotshme, ku shoqëria vazhdimisht sulmon rolet e gjinive. Baballarët mund t'i trajnojnë djemtë e tyre që të përballen me sfidat më të mëdha të jetës në



natyrë, si edhe mund t'i trajnojnë ata që të ndihmojnë me punët në shtëpi, dhe që të dyja këto aspekte të jetës lidhen me shembuj biblikë.

“Si shigjeta në duart e një trimi, kështu janë bijtë e rinisë. Lum ai njeri që ka kukurën e tij plot!” (Psalmi 127:4,5).

Ekziston një element mbrojtës tek gjinia mashkullore, element i cili është i dhënë nga Perëndia. Metafora në këtë fragment vë në dukje forcën e fëmijëve besnikë, me një shenjë rreth vlerës së bijve të fortë. Mësojini djemtë tuaj që ta ilustrojnë me shembuj dashurinë flijuese dhe të jenë gati të japin jetën e tyre për hir të nënës, motrës, apo kujtdo që kërcënohet nga e keqja.

“Timoteut, birit të vërtetë në besim; hir, mëshirë dhe paqe prej Perëndisë Atit tonë dhe prej Jezus Krishtit, Zotit tonë”. (1 Timoteut 1:2).

Ja dhe e vërteta themelore në rritjen e një djali: sigurohuni, duke e bërë këtë gjë qëllimin tuaj suprem, që ai të bëhet “biri i vërtetë në besim”. Nëse i jepni gjithçka në këtë botë, por humbisni shpirtin e tij, atëherë keni pësuar humbje të parikuperueshme.

“O biri im, Absalom; biri im, biri im, Absalom! Të kisha vdekur unë në vendin tënd, o Absalom, biri im, biri im!” (2 Samuelit 18:33).

Në të gjithë Shkrimin, ky është një nga vargjet më të trishta, një varg që të thyen zemrën. Por ai flet mu në thelb të asaj se çfarë është realisht që të jesh një baba i perëndishëm. Një baba i perëndishëm do të bënte çdo sakrificë për të shpëtuar birin që është në situatë të vështirë. Për Davidin, Absalomi nuk mund të shpëtohej më. Për ju, ky përgjërëm në emër të birit tuaj mund të bëjë ndryshimin.

disa vjet, gjatë periudhës që unë u linda dhe isha fëmijë. Edhe ai, edhe nëna ime kanë vazhduar të jenë shumë aktivë me kishën. Madje, babai im ishte pastori i fëmijëve të mi që përpara se ky titull të ishte i zakonshëm. Ata modeluan në sytë e mi shërbesën dhe një ecje plot energji me Perëndinë, dhe unë kujtoj në mendjen dhe shpirtin tim kaq shumë shembuj nga jeta e tyre.

BEKIMI

Kur jeta e një babai të perëndishëm është në përputhje me rrëfimin që ai i bën besimit të tij, atëherë fjalët e tij marrin fuqi të jashtëzakonshme mbi fatin e fëmijës. Ta bekosh me fjalët e tua fëmijën është diçka jetike në mënyrë që ta rritësh atë me mbrojtje të përshtatshme frymërore.

Bekimi i fëmijëve tuaj nuk është thjesht një ndikim për jetët e tyre; diçka dinamike ndodh gjithashtu edhe në jetën e prindit. Patjetër që bekimi i djemve të mi bën gjëra të mëdha për ta, por kur unë i shoh djemtë e mi si bekime të Perëndisë në jetën time, dhe kur shpall bekime në jetët e tyre, unë i shoh ata me një sy tjetër. Ata nuk janë barrë për mua. Nuk më kanë ngecur nëpër këmbë. Nuk janë fëmijë të prapë. Por ata kthehen në rezervuarë të pamasë gëzimi që më injektohen thellë në çdo pjesë të qenies sime.

Gjatë viteve që kam kaluar në shërbesë, kam dëgjuar dhe kam parë shumë gjëra në ambiente familjare që tregojnë se nëna dhe babai nuk i kanë zemrat atje ku duhet, madje as për të qenë të aftë të shpallin bekime të vërteta. Ata i shohin fëmijët e tyre si kokëçarje të padëshirueshme, si një kosto

Fjala e Perëndisë dhe vajza juaj

“Ai bën që gruaja shterpë të banojë në familje si nënë e lumtur e fëmijëve”. (Psalmi 113:9).

Pavarësisht nëse bija juaj zgjedh që të martohet ose jo, një dhuratë e jashtëzakonshme që mund t’i jepni asaj do të ishte të mbanit në fokus, gjatë gjithë rritjes së saj, fuqinë e potencialit që ajo mund të ketë për të ndikuar tek të tjerët. Ndërsa rrokni potencialin që ajo ka, për t’i dhënë formë brezave të ardhshëm, do ta përkushtoni veten për t’ia kaluar urtësinë dhe përkushtimin frymëror për të cilën ajo do të ketë nevojë.

“Stolisja juaj të mos jetë e jashtme, ajo e të gërshetuarit të flokëve, e të varurit të stolive të arta, a të veshurit e rrobave luksoze. Por njeriu i fshehur i zemrës, stolisur me paprishjen e frymës së butë dhe të qetë, i cili është shumë i çmuar përpara Perëndisë”. (1 e Pjetrit 3:3,4).

Sensualiteti shpërthyes i kulturës sonë i huazon këtij pasazhi një forcë paralajmëruese. Kjo nuk është një thirrje për masa të ashpra, por për



një sens prioriteti. Rriteni bijën tuaj që t’i japë përparësi bukurisë së saj të brendshme dhe përkushtimit si një ndjekëse e Krishtit, ndërkohë që e ndihmoni që gjithashtu të administrojë bukurinë e saj të jashtme. I qëndroni afër ndërsa rritet (daljet baba-bijë janë shumë të mira) në mënyrë që të mësojë se si e respekton bukurinë e vërtetë një burrë i perëndishëm dhe se si ai nuk do të përfitonte prej saj.

“Kush e di nëse është pikërisht për një kohë të tillë që ti ke arritur në pozitë mbretërore?” (Esteri 4:14).

Vajza juaj duhet ta dijë se plani që Perëndia ka për të nuk duhet të jetë kurrë i kufizuar për shkak të gjinisë së saj. Ndërsa ajo dallon “pozitën e saj mbretërore” brenda kohës së përsosur të Perëndisë, ju duhet të jeni mbështetësi më i madh për të. Bëhuni Mardoheu i urtë që e këshillon atë për të arritur madhësinë.

“Dhe një grua, me emër Lidia, që ishte tregtare të purpurtash, nga qyteti i Tiatirës dhe që e adhuronte Perëndinë, po dëgjonte. Zoti ia hapi zemrën për të dëgjuar ato që thoshte Pali. Dhe si ajo u pagëzua me shtëpinë e saj, na u lut duke thënë: ‘Në qoftë se më keni gjykuar se jam besimtare ndaj Zotit, hyni në shtëpinë time dhe rrini’. Dhe na detyroi të pranojmë”. (Veprat e Apostujve 16:14,15).

Tregtarët e djeshëm të “të purpurtave” mund të jenë drejtorët ekzekutivë të kompanive të suksesshme të ditëve tona. Në një botë që, me të drejtë, i inkurajon gratë për të arritur madhësinë, ndihmoheni vajzën tuaj që gjithashtu ta paraqesë veten e saj si një “besimtare ndaj Zotit”, e cila përkushtohet për t’u bashkuar me shërbëtorë të tjerë të Perëndisë për të përmbushur Porosinë e Madhe dhe për t’u bërë personi që Perëndia e ka përcaktuar të jetë.

financiare, si pengesa për të përmbushur ëndrrat e tyre.

Nëse do të mund ta theksoja në mënyrë më të fuqishme një të vërtetë për baballarët e sotshëm, do të thosha: "O baba, fokusoje zemrën tënde tek fëmija yt si një bekim që të është dhënë për t'u administruar, jo si një projekt për t'u menaxhuar".

Kur administroni atë që Perëndia ka vendosur në zemrat e fëmijëve tuaj dhe kur i ndihmoni të arrijnë tek Ai potencialin e tyre më të madh, atëherë po i çoni në një stad suksesi dhe rëndësie që është shumë herë më i lartë sesa ai që do të arrinit duke i shtyrë të ndiqnin ëndrrat tuaja.

Përgjatë gjithë jetës sime kam ndjerë një bekim të madh, që ka ardhur si dhuratë, nga prindërit e mi; por kjo ka ndodhur edhe së fundmi nga ndryshimi që sapo kemi bërë në shërbesën tonë. Kur u transferuam nga shërbesa jonë rajonale në Dakotën e Jugut për të shërbyer në zyrën kombëtare në Springfield të shtetit të Mizurit, prindërit na thanë: "Do të donim shumë që ju të ishit më afër shtëpisë, por ne e vlerësojmë thirrjen e Perëndisë në jetën tuaj më shumë sesa t'ju kemi afër".

Ky është një bekim. Me këto fjalë, prindërit po na thonë: "Po ju lemë të lirë. Po administrojmë atë që Perëndia ka vendosur brenda jush".

Të njëjtën gjë dua edhe unë për dy djemtë e mi. Nëse i administroj ato që Perëndia ka vendosur në zemrat e tyre, në vend që të fokusohem ekskluzivisht tek menaxhimi i tyre përmes disiplinës, bindjes dhe

pajtimit, atëherë kjo e ndryshon çështjen. Kjo e transformon përvojën time të prindërimit.


A do të thotë kjo se nuk ka hapësirë për udhëzim dhe disiplinim? Sigurisht që jo. Mund të bekonit nga distanca, por nuk mund të prindëroni nga distanca. Një bekim i thjeshtë pa kaluar kohë me fëmijën tuaj është po aq bosh sa bekimi që përshkroi apostulli Jakob: "Në qoftë se një vëlla ose një motër janë të zhveshur dhe u mungon ushqimi i përditshëm, edhe dikush nga ju u thotë atyre: 'Shkoni në paqe! Ngrohuni dhe ngopuni', dhe nuk u jepni atyre gjërat e nevojshme për trupin, ç'dobi ka? Kështu edhe besimi, në qoftë se s'ka vepra, është i vdekur në vetvete" (Jakobi 2:15-17).

Unë do ta perifrazoja këtë fragment dhe do të thosha: "Bekimi në vetvete, në qoftë se nuk ka investim personal dhe udhëheqje në lutje, është i vdekur."

UDHËZIMI

"Dëgjo, o biri im, mësimet e atit tënd dhe mos i lër pas dore mësimet e nënës sate" (Fjalët e Urta 1:8).

Udhëzimet e themeluara në Fjalën e Perëndisë do të prekin mbi të gjithë spektrin e temave. Por çelësi është vazhdimësia. Do të përdor vetëm një koncept si shembull. Që në fillimet e prindërimit tonë, unë dhe bashkëshortja ime, nisëm të punonim me bijtë tanë për sa i përket konceptit të mirëbesimit – që sa më shumë mirëbesim të ndërtohet, aq më shumë liri do të marrësh si rrjedhojë.



“Kur të kërkojmë që të bësh diçka, dhe ti e bën, atëherë kjo ndërton mirëbesim. Dhe kur të kërkojmë që të bësh diçka, dhe ti nuk e bën, atëherë kjo e ul nivelin e mirëbesimit”.

Unë dhe djali im i madh po bënim një bisedë për një çështje krejtësisht të ndryshme, dhe atij sikur iu ndez një llambë në mendje. “Ah, tani e kuptova”, tha ai. “Pra, kur unë bëj këtë, kjo e rindërton mirëbesimin”.

Ai nuk i kishte respektuar rregullat e rrugës, ndërsa po ngiste biçikletën. “Kjo është diçka e rëndësishme”, ngula këmbë unë, “sepse kur e shoh që ti i respekton rregullat me biçikletë, atëherë kjo gjë më ndihmon mua që një ditë të mund të të besoj për të të dhënë makinën”.

Por si ia bëni kur udhëzimi juaj shpërfillet, ose kur bindja e fëmijës është shumë e pakët? Disiplina bëhet e nevojshme, dhe shpesh ajo zbatohet në mënyrën e gabuar.

DISIPLINA

Çelësi për një disiplinë të perëndishme gjendet tek motivimi juaj. Duhet të bëni dallim midis disiplinës për shkak se doni që fëmija juaj të jetojë sipas pritshmërive tuaja dhe disiplinës ku ju përqendroheni tek më e mira për të ardhmen e tyre. Është e vërtetë që kufiri midis të dyjave mund të jetë i vagullt e i paqartë. Është kollaj të mendoni se po përqendroheni tek më e mira për ta, kur në të vërtetë jeni shumë egoistë.

Shumë herë egoja jonë na e vjedh motivimin e perëndishëm në disiplinimin e fëmijëve tanë. Unë nuk dua që të tjerët të mendojnë se jam një prind i keq kur fëmija im më ‘bën numra’ në restorant. Megjithëse ajo që po bën fëmija nuk është domosdoshmërisht e keqe, mua ajo gjë më vë në siklet. Prandaj, çfarë ndodh në shpirtin e fëmijës tim nëse e dispijnoj në mënyrë të rreptë vetëm sepse nuk dua të jem në siklet (apo i turpëruar)?

Djali im ishte rreth 3 vjeç kur një miku ynë pastor ofroi të na çonte në një restorant në të cilin nuk kishim qenë asnjëherë. U ulëm me djalin tim dhe me djalin e mikut tonë, i cili kishte pak a shumë të njëjtën moshë. Djemtë po silleshin mjaftueshëm mirë; nuk po bëheshin të padurueshëm. Por në atë moshë ishin aktivë, dhe sigurisht, që i ndjemë sytë e njerëzve.

Madje një person u siguria që të vinte pranë nesh dhe t’i thoshte kamerierit, në mënyrë që ta dëgjonim edhe ne: “Do të doja të ulesha në pjesën ku nuk lejohen fëmijët”.

Në qoftë se do ta dispijnonim fëmijën tonë për shkak se një trevjeçar nuk mund të sillet mirë në një ambient për të rritur, atëherë do të kishim motivin e

gabuar. Ndonjëherë, dhe ndoshta më shpesh nga sa e vëmë re, ne veprojmë të nxitur nga motivi i gabuar.

Por kur motivi ynë është i orientuar siç duhet, me lutje, atëherë nuk mund ta anashkalojmë identifikimin e kufijve. Dhe kufijtë më të mirë për t’u komunikuar janë ata që janë përvijuar në Shkrim. Mund t’i ndihmojmë fëmijët tanë që të kuptojnë se kur i kanë shkelur këta kufij dhe kur është e përshtatshme që t’i dispijnoj ata. Në përfundim, motivimi i duhur, që qëndron pas veprave të mbushura me dashuri të disiplinës, i lidhur me sistemin e kufijve sipas standardit të Perëndisë, krijon një dinamikë prindërimi me një ndikim të pamasë.

BEKIMI I NJË ATI

Baballarët që marrin përkushtim për t’i rritur fëmijët e tyre “në disiplinë dhe në këshillë të Zotit” (Efesianëve 6:4) – përmes pranisë, shembullit, bekimit me gojë, udhëzimit dhe disiplinës – krijojnë një kanal për favorin hyjnor tek ato jetë të reja. Dhe ky kanal e ka rrjedhën në të dyja drejtimet. Bekimi i atit mbart gjithashtu edhe premtimin e favorit të Perëndisë mbi vetë atin.

Për një baba të perëndishëm është një gëzim i pamasë të shikojë birin apo bijën e tij teksa gërmojnë thellë në një marrëdhënie me Perëndinë. Fëmija i ushqyer frymërisht, i cili rritet dhe bëhet një anëtar i pjekur dhe i frytshëm i trupit të Krishtit, do ta shumëfishojë ndikimin e të atit përmes një rrethi jetësh të prekura që sa vjen e zgjerohet.

Megjithëse bekimi i bijve të Jakobit në shtratin e tij të vdekjes ishte edhe i bukur, edhe i dhimbshëm, historia e plotë e ndikimit të tij në jetët e tyre, e plotëson ekuilibrin e Shkrimit dhe do të vazhdojë të shkruhet përjetësisht me germa të mëdha. Në të njëjtën mënyrë do të shkruhet edhe historia e plotë e brezave të ardhshëm që mund të formohen sot nga etërit e perëndishëm.



MARK ENTZMINGER, drejtor i Shërbesës së Fëmijëve për Asamblëtë e Perëndisë, Springfield, Missouri.



SCOTT HARRUP, është redaktori menaxhues i revistës “Pentecostal Evangel”, Springfield, Missouri.

A photograph of a man with a shaved head and a light beard, wearing a blue and red plaid button-down shirt. He is looking off to the right side of the frame with a thoughtful expression. The background is a plain, light-colored wall.

8

ZAKONE

*të Martesave të
Perëndishme*

Nga: ROBERT S. PAUL

Ndërsa jepni mësim dhe predikoni mbi martesat e shëndetshme, dhe ndërkohë që i këshilloni çiftet që kanë nevojë të ndërtojnë martesa të forta, gjeni mënyra për t'iu treguar atyre këto karakteristika kyçe.



S

humë rrallë ndodh që martesat e mira të jenë të mira rastësisht. Mund të ketë disa përjashtime, por, përgjithësisht, stadin e një martese të mirë e arrijmë duke investuar mjeshtërisht dhe besnikërisht kohë dhe energji në martesat tona. Dëshira e Zotit tonë është që të gjithë të martuarit të kenë martesa kuptimplota dhe përmbushëse. Ai është një Perëndi i marrëdhënieve, që ekziston në një marrëdhënie triune (tre në një) të përsosur. Në deklaratat e Tij, Jezusi tha se erdhi me qëllim që ne të përjetojmë personalisht jetën me bollëk (Gjoni 10:10). Në një kulturë me marrëdhënie të thyera, a nuk do të ishte më kuptimplotë që kisha t'i tregonte botës se si bollëku mund të shkojë përtej individit, pra, në një martesë të përkushtuar dhe që e nderon Perëndinë?

Në shërbesë, martesë paraqet një mundësi të artë për të ndarë ungjillin. Lavdi Zotit që njerëzit vazhdojnë të kërkojnë shpesh ndihmë në kishë, qoftë kur martesë e tyre ka probleme, por edhe me ide për t'i bërë martesat e tyre më të mira. A nuk është, në thelb, disi më e lehtë puna e shërbesës kur njerëzit e kuptojnë vetë nevojën që ata kanë dhe vijnë tek ju, sesa kur ju duhet t'i gjeni e më pas t'i nxirrni nevojat në pah?

Njerëzit shpresojnë që ne të kemi përgjigjet dhe duan të shohin prova se ne po bëjmë atë që themi dhe gjithashtu duan të na shohin teksa e përjetojmë personalisht frytin e marrëdhënies sonë me Krishtin. Ata duan të shohin vërtetësinë e fjalëve tona. Dhe, ajo që ne kemi për të ofruar, është shumë më tepër sesa disa fjalë boshe dhe një shpresë e zbrazët.

Në këtë artikull, unë ofroj tetë karakteristika, përjasje dhe qëndrime të cilat karakterizojnë martesat kuptimplota, e të kënaqshme dhe që e nderojnë Perëndinë. Këto ide janë të vërtetuara; dhe fatmirësisht, janë mjaft të lehta për t'u përdorur në shërbesë, si edhe për t'i zbatuar në martesat tuaja.

Ndërsa jepni mësim dhe predikoni mbi martesat e shëndetshme, dhe ndërkohë që këshilloni çiftet që kanë nevojë të ndërtojnë martesë të forta, gjeni mënyra për t'ua treguar atyre këto karakteristika kyçe.

Unë e përkufizoj si martesë të mirë, atë martesë, në të cilën, të dy bashkëshortët e duan martesën e tyre dhe janë të emocionuar me drejtimin që ajo ka marrë. Për më tepër, një martesë e mirë është e mundur kur të dy bashkëshortët ndajnë dashurinë e Krishtit dhe i japin lavdi Atij. Madje, për t'u kualifikuar si martesë e mirë, nuk është e nevojshme që çiftet ta duan martesën e tyre për të njëjtat arsye, për aq kohë sa të dy e duan martesën. Kjo ide do të jetë një çlirim i madh për shumë vetë, të cilët ndihen sikur janë aq tepër të ndryshëm njëri nga tjetri, sa që e shohin të vështirë që martesë e tyre t'ia dalë mbanë.

Një nga fushat në të cilat kisha shpesh, në mënyrë të shkujdesur, pengon rritjen e martesave të suksesshme e të kënaqshme është në rrjedhimin e paperceptueshëm lehtësisht se pasi martoheni, martesë bëhet më e rëndësishme sesa njerëzit brenda saj.



1 RESPEKTONI/NDERONI NDRYSHIMET

Ndryshimet midis njerëzve, të cilat janë të bollshme, kanë potencialin për të krijuar sfida në çdo marrëdhënie, sidomos në martesë. Ne vijmë në martesë me personalitete të ndryshme, nga familje të ndryshme, me shpresa, ëndrra, pritshmëri dhe preferenca të ndryshme. Në fakt, në shumë mënyra martesë është rrënjësisht një përvojë ndërkulturore. Si rrjedhojë, kur këto ndryshime përplasen me njëra-tjetrën, është shumë e lehtë që të duken si një problem i vërtetë. Në realitet, zakonisht nuk janë ndryshimet problemi në një martesë. Perëndia i krijoi enkas ndryshimet midis një burri dhe një gruaje, posaçërisht për një qëllim të caktuar, dhe Ai dëshiron që ne t'i nderojmë dhe t'i përdorim këto ndryshime, dhe jo t'i eliminojmë ato (1 Korintasve 12).

Në një martesë që e nderon Perëndinë, bashkëshortët dinë si të shprehin vlerësimin dhe vlerën jo vetëm për atë që bën tjetri, por gjithashtu edhe për atë që ai apo ajo është. Ekziston një mundësi e vazhdueshme për ta ndihmuar njëri-tjetrin që ai apo ajo të shohë ato gjëra në veten e tij apo të saj, të cilat Perëndia qëllimisht i krijoi,

i vlerëson dhe i do; gjëra të cilat secili bashkëshort mund të mos i shohë. Zakonisht nuk është e vështirë të shihen pikat problematike, por mund të jetë shumë e vështirë që të shohim vlerën e përjetshme që Perëndia ka caktuar tek secili prej nesh. Identifikimi, inkurajimi dhe nxjerrja në pah e të mirës ka më shumë shanse për të ndihmuar në ndërtimin e një marrëdhënieje të shëndoshë, sesa vënia në dukje e të keqes.

2 TREGONI INTERES TË SINQERTË PËR NJËRI-TJETRIN

Një nga karakteristikat e zakonshme të martesave që kanë marrë tatëpjetën, është humbja graduale e interesit ose marrja e njëri-tjetrit si të mirëqenë. Një pjesë e mirë e personave të martuar e harrojnë faktin e thjeshtë se esenca e një romance të vërtetë është magjepsja dhe interesi për njëri-tjetrin.

Kur çiftet shijojnë në fillim atë fazë emocionuese të admirimit, ata janë të magjepsur nga njëri-tjetri. Çdo fjalë e dëgjojnë me vëmendje dhe shijojnë procesin e njohjes. Në fakt, një përkufizim i dobishëm për intimitetin është rrugëtimi i të bërit të njohur për njëri-tjetrin dhe i të njohurit të njëri-tjetrit. Kur jeni shumë të interesuar për dikë, dhe kur ai person është i interesuar për ju, me siguri ndiheni mirë, që dikush kujdeset për ju dhe ju do.

Çiftet duhet të jenë të përkushtuar ndaj njohjes së njëri-tjetrit me qëllim që ta mbajnë gjallë romancën dhe pasionin në martesën e tyre. Është shumë e lehtë, pasi keni qëndruar bashkë për një sërë vitesh, që t'i dorëzoheni iluzionit se në të vërtetë nuk ka ngelur më ndonjë gjë për të zbuluar. Megjithatë, e vërteta është se Krijuesi ynë na ka krijuar në mënyrë të mahnitshme dhe të ndërlikuar, dhe një jetë nuk është aspak e mjaftueshme për ta njohur plotësisht një qenie njerëzore.

Unë kam 32 vjet i martuar me bashkëshorten time, dhe vazhdimisht mësoj gjëra të reja rreth saj. Dhe, për t'i bërë gjërat edhe më interesante ... ajo vazhdon të ndryshojë. Por ky është lajm shumë i mirë, duke qenë se esenca e romancës së vërtetë është një magjepsje për gjithë jetën me gruan time. Ndonjëherë, ajo më konfuzon në maksimum. Në fund të fundit, ajo është shumë ndryshe nga unë. E megjithatë, kam mësuar që ta mbaj zjarrin tonë të ndezur duke qëndruar qëllimisht i interesuar për të, si dhe duke kërkuar mënyra që t'ia bëj të ditur se sa magjepsëse më duket ajo.

3 FOKUSOHUNI TEK POZITIVJA

Në këtë botë të rënë, nuk do të kemi kurrë deficit gjërash negative dhe problemesh. Një bashkëshort i papërsosur apo një bashkëshorte e papërsosur, që është në rritje e sipër, shpesh mund t'ua prishë planet tuaja të mirë-planifikuara dhe do të krijojë një recetë të vazhdueshme zhgënjimi. Megjithatë, duke pasur çdo ditë një kohë të kufizuar në dispozicion për t'u menduar, mënyra se si e investoni atë kohë do të ndikojë thellësisht në përvojat dhe ndjenjat tuaja.

Le të themi se keni dy orë kohë në ditë për të menduar rreth bashkëshortit apo bashkëshortes tuaj dhe martesës suaj. Nëse treçerekun e kësaj kohe do ta investoni duke menduar për gjërat që ju bezdisin dhe vetëm një çerek të kohës mbi gjërat që pëlqeni dhe vlerësoni, si do të ndiheni? Ndoshta tri herë më shumë një person negativ, sesa pozitiv.

Nuk po sugjeroj këtu që negativja të shpërfillet, por jeni ju që e vendosni se si do e investoni kapitalin

tuaj të mendimeve. Mënyra se si e investoni atë që Perëndia ju ka dhënë, do ta ndikojë në mënyrë të jashtëzakonshme atë që ju kthehet nga ky investim. Në përgjithësi, ata që e shijojnë martesën e tyre, shpenzojnë më shumë kohë duke menduar mbi gjërat që u pëlqejnë, që duan, çmojnë dhe vlerësojnë te bashkëshorti apo bashkëshortja dhe te martesë e tyre (Filipianëve 4:8).

4 INVESTONI TE NJERËZIT

Një nga fushat në të cilat kisha shpesh, në mënyrë të shkujdesur, pengon rritjen e martesave të suksesshme e të kënaqshme është në rrjedhimin e paperceptueshëm lehtësisht, se pasi martoheni, martesë bëhet më e rëndësishme sesa njerëzit brenda saj. Për të jetuar një jetë që nderon Krishtin, si dhe për të pasur një martesë që nderon Krishtin, nevojitet sakrificë. Megjithatë, rritja, zhvillimi dhe mirëqenia e individëve janë elemente kritike.

Martesa nuk ekziston e ndarë nga njerëzit që janë në të, dhe martesë nuk mund të jetë më e shëndetshme sesa individët që përfaqëson. Kur dy njerëz martohen, secili prej tyre vazhdon të jetë plotësisht i përgjegjshëm për t'u bërë personi që Perëndia e krijojë dhe e thirri të bëhej. Në martesë, ata thjesht kanë shtuar një entitet (martesën), të cilën gjithashtu duhet ta ushqejnë e ta rrisin. Në fakt, pjesët e përjetshme të martesës janë individët, jo marrëdhëniet (Mateu 22:29, 30). Nëse, në mënyrë të gabuar, e bëjmë martesën më të rëndësishme sesa njerëzit në të, atëherë i inkurajojmë ata që të fokusohen më shumë tek gjërat e përkohshme sesa tek ato të përjetshme.

Jezusi tha se urdhërimi më i madh është që ta duam Zotin me gjithë qenien tonë dhe t'i duam të tjerët porsivetveten (Mateu 22:36-40). Një martesë e mirë i nxit njerëzit që të gjejnë një ekuilibër të shëndetshëm midis tërësisë dhe mirëqenies së secilit individ, dhe shëndetit dhe mirëqenies së marrëdhënies, ndërkohë që i kushtojnë vëmendje mënyrës se si secili do t'i mbështesë qëllimet përfundimtare të Perëndisë.

5 MËSONI TË KOMUNIKONI MIRË

Një nga shkaqet më të përmendura nga çiftet në krizë që çon në probleme martesore është komunikimi i pakët (ose i varfër). Por nuk ka sesi të jetë ndryshe, duke parë ndërlikimin e qenësishëm e të natyrshëm të komunikimit verbal. Po t'i shtojmë martesës, kësaj loje me rrezik të lartë, edhe ndjenjat e forta, atëherë komunikimi veçse ndërlikohet edhe më shumë.

martësën e tyre, zakonisht thonë se iu pëlqen që të Ato çifte që raportojnë se kanë një nivel të lartë kënaqësie dhe gëzimi në flasin me njëri-tjetrin dhe se flasin shpesh. Një mënyrë efikase për të rritur ndjenjën e afërsisë, ka të bëjë me tregimin e shpresave dhe ëndrrave, gëzimeve dhe fitoreve tuaja. Por gjithashtu kjo kërkon edhe tregimin e zhgënjimeve, lëndimeve, sfidave dhe pengesave tuaja, duke qenë se intimiteti i vërtetë do të thotë që ta dini se dikush është aty për ju dhe me ju.

Komunikimi i mirë martesor është gjithmonë plot respekt e kujdes. Mos harroni se janë të përfshira zemrat tuaja dhe Perëndia na urdhëron që t'i ruajmë zemrat tona mbi çdo gjë tjetër (Fjalët e Urta 4:23). Të folurit me butësi ndërsa e merrni më ngadalë, mund të jetë një kapital goxha me vlerë. Kjo gjë kërkon durim dhe që të flisni me radhë. Në kuptimin më elementar, duhet të ketë gjithmonë vetëm një folës dhe një dëgjues njëkohësisht, duke e lejuar çiftin të tregojë këtë lloj interesi dhe kujdesi për njëri-tjetrin.

Edhe pse është shumë e rëndësishme për një komunikim të mirë që të mësojmë të flasim qartësisht, shpeshherë është më e vështirë që të mësojmë si të jemi një dëgjues i mirë. Pjesa më e madhe e defekteve në komunikim ndodh kur dëgjuesi hiqet vetëm si dëgjues, por në fakt është një folës që po pret radhën që të flasë. Në vend që të dëgjojë atë që po thotë folësi, personi tjetër po planifikon një kundërshtim ose po përpiket që të gjejë një mënyrë për t'i treguar folësit gabimet e ideve të tij. Kjo lloj përjasaje nuk do të komunikojë kurrë dashuri dhe kujdes. Në fakt, më shumë e prish marrëdhënien sesa e ndërton atë. Një dëgjim i mirë kërkon përqendrim në dëgjimin e folësit, kuptimin e asaj që po thotë ai dhe tregimin e përkujdesjes ndaj tij. Duhet dëgjuar edhe ato që po thotë, edhe ato që po ndjen ai, ndërkohë që i komunikoni se mendimet dhe ndjenjat e tij kanë rëndësi për ju.

6 VEPRONI SI NJË SKUADËR

Një nga mekanizmat e armikut është që t'ia heqë vëmendjen çiftit nga armiku i vërtetë, satani, dhe ta drejtojë atë për tek njëri-tjetri, sikur ata të ishin kundërshtarë.

Kur angazhohemi në luftë për pushtet, duke kërkuar që të fitojmë (ose të mos humbasim, që në thelb është e njëjta gjë), ne po luajmë sipas rregullave të tij. Shkrimi na thotë se një shtëpi e përçarë në vetvete nuk mund të qëndrojë (Mk. 3:23-25). Unë nuk rekomandoj asnjëherë rregulla të drejta luftimi. Unë nuk dua të luftoj (grindem) me bashkëshorten time; ajo nuk është armiku im. Unë dua që në shtëpinë time të mos ketë luftime (grindje, sherre).

Martesa është një sport në skuadër. Çiftet duhet t'i diskutojnë ndryshimet. Por ajo që bën ndryshimin është mënyra se si i qasen njëri-tjetrit me ndryshimet e tyre. Satani dëshiron që ne të besojmë se në një mosmarrëveshje martesore mund të ketë në fakt një fitues dhe një humbës. Megjithatë, kur jeni pjesë e një skuadre, ose fitoni si skuadër, ose humbisni si skuadër. Ideja e një rezultati me fitues dhe humbës është një iluzion që vjen nga humnera e ferit.

Përkundrazi, çiftet e suksesshme adoptojnë një politikë pa humbës, dhe nuk lejojnë që asnjëri prej bashkëshortëve të largohet duke u ndier si humbës. Ata punojnë si shokë skuadre bashkë me Zotin dhe e lejojnë Perëndinë që t'i ndihmojë në gjetjen e zgjidhjeve që iu pëlqejnë të dyve. Ndryshimet i kapërcejnë sipas atyre mënyrave që i bëjnë të ndihen në një paqe dhe fitore hyjnore.

Madje ndonjëherë Perëndia i drejton njerëzit drejt atyre rezultateve të cilat nuk dukeshin të mundura nga ana njerëzore. Por fatmirësisht, me anë të hirit të Perëndisë, ne nuk duhet ta kufizojmë veten me atë që duket e mundur nga ana njerëzore. Zoti ynë është i përkushtuar në mirëqenien tonë personale dhe në unitetin tonë. Nëse ne e lejojmë, Ai do të na bashkojë me veten.

7 KRIJONI AMBIENTIN MARTESOR IDEAL

Perëndia na ka krijuar me një dëshirë për një lidhje të thellë intime. Asnjë marrëdhënie nuk është në gjendje ta përmbushë këtë dëshirë më mirë sesa martesa. Intimiteti që të kënaq ka të bëjë gjithmonë me njohjen e personit tjetër dhe të qenit të njohur.

Kjo kërkon një masë të madhe sinqeriteti dhe cënueshmërie, dhe për ta bërë këtë duhet kurajë.

Në qoftë se e dashurojmë dikë aq sa t'ia hapim zemrën tonë, atëherë kjo gjë shton mundësinë reale për t'u lënduar. Të gjithë jemi lënduar në marrëdhënie. Si rrjedhojë, mbajmë një qëndrim të kujdesshëm dhe të mbrojtur ndërsa përpiqemi që të krijojmë intimitet. Me qëllim që të mos lëndohemi më shumë, veshim lloje të ndryshme armaturash. Fatkeqësisht, për t'u lidhur në një mënyrë të thellë intime, kërkohet që ne të jemi të hapur; në gjendjen tonë fillestare, lakuriq dhe pa turp (Zanafilla 2:25), dhe pa frikë.

Ne duhet të ndihemi me të vërtetë të sigurt fizikisht, mendërisht, emocionalisht dhe nga ana frymërore, për të qenë aq të qetë e të hapur sa të krijojmë lidhje të afërta. Tek Letra e Parë e Gjonit 4:18, thuhet se: "Në dashuri nuk ka frikë, madje dashuria e përsosur e nxjerr jashtë frikën." Ato çifte që duan të rriten dhe të përjetojnë thellësitë më përmbushëse dhe kuptimplota të intimitetit e kuptojnë këtë gjë, dhe, për këtë arsye, krijimin e një ambienti të sigurt, e bëjnë prioritetin e tyre të parë. Ata marrin kohë për të kuptuar domethënien që kjo ka për njëri-tjetrin, dhe punojnë individualisht, dhe së bashku, për atë qëllim.

8 BASHKOHUNI NË QËLLIMET E PERËNDISË

Perëndia e përcaktoi martesën si një përfaqësuese simbolike në botë për martesën midis Tij dhe Kishës, nuses së Tij (Efesianëve 5:32). Qëllimi i Tij për martesën është që ajo të jetë e përhershme, njësoj si përkushtimi i Tij ndaj nesh. Me siguri Zoti ynë i dashur dhe i përkushtuar dëshiron që martesë të na bekojë, por akoma edhe më shumë, Ai dëshiron që martesë të sigurojë një reflektim pozitiv të Tijin. Prandaj, në bërthamën e saj, martesë është thellësisht e qëllimshme: një mjet për të përmbushur qëllimet e Perëndisë.


Çiftet e martuara të cilat po përparojnë në marrëdhënien e tyre, do të kërkojnë qëllimisht për mënyra si ta përdorin martesën e tyre për t'i shërbyer Perëndisë. Duke qenë se Jezusi i bleu me një çmim jetët tona, lumturia dhe përmbushja vetjake nuk mund të jenë objektivi përfundimtar. Megjithatë, një nga misteret më të mëdha të besimit tonë është mënyra se si gjendja jonë flijuese si shërbëtorë lidhet me zemrën e një Ati të dashur, i cili dëshiron gjëra të mrekullueshme për ne. Kërkimi së bashku për mënyrën se si Perëndia dëshiron të na përdorë për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e Tij, si individualisht, ashtu edhe si një çift, na lejon që të zbulojmë një kuptim tërësisht përmbushës e të

përqendruar në Krishtin për martesat tona; një kuptim i cili shtrihet përtej ndjenjës së të qenit i lumtur.

Zoti ynë, krijuesi dhe Ai që i jep jetë gjithë universit, jo vetëm që na fal dashuri, por Ai është esenca e dashurisë (1 Gjonit 4:8). Në fund të fundit, ai dëshiron vetëm të mirën për popullin e Tij, qoftë si individë, qoftë në marrëdhënie. Dëshirat dhe kërkesat nga thellësia e qenies sonë përmbushen tek Ai. Dhe shpresa më e madhe që kemi për t'i ofruar një bote të humbur e të uritur është dëshmia e asaj që pretendojmë se është e mundur me Krishtin. Ndërsa e lejojmë Krishtin të mbushë jetët tona, vetë qeniet tona e reflektojnë Atë, dhe drita e Tij shkëlqen përmes nesh. Në këtë mënyrë ne iu ofrojmë të gjithëve që të shohin një dëshmi të lavdishme të Krishtit. A mund të mendoni ndonjë tërheqje më të fuqishme ndaj Krishtit sesa njerëz që dëshmojnë realisht lirinë, gëzimin, fuqinë dhe paqen që ne i dimë se janë të mundura me Zotin tonë?

Në të njëjtën kohë, kultura jonë e martesave të thyera po e humbet me shpejtësi shpresën që një martesë jetëgjatë e përmbushëse të jetë e mundur. Kur ne bashkë me bashkëshortin apo bashkëshorten tonë punojmë me Perëndinë për të krijuar një martesë të mrekullueshme, jemi duke i shërbyer Atij në mënyrë kuptimplotë. Së bashku ne japim edhe më shumë dëshmi se kush është Perëndia dhe se çfarë gjërash janë të mundura me Të. Duke e lejuar Perëndinë që të mbërthejë zemrat tona dhe të na ndihmojë të rritemi në martesat tona, faktikisht, po investojmë bashkë me Të për të rritur mbretërinë e Tij. Ecja bashkë me Krishtin në martesë ofron situatën më të mirë e njëkohësisht edhe fitimtare për të gjithë.

Ndihma që mund t'i japim një kishe me martesë dhe familje të shëndetshme dhe të përqendruara te Krishti, do të krijojë një dëshmi kundër-kulturore e cila do të marrë goxha vëmendje. Në ç'vend tjetër po lulëzojnë martesat? Askund. Njerëzit vijnë tek ne për ndihmë dhe shpresë. Me anë të hirit të Perëndisë, ne kemi një drejtim, kemi mundësi dhe kemi edhe ndihmë, edhe shpresë për të ofruar.



ROBERT S. PAUL, bashkëpresident dhe këshilltari kryesor intensiv i martesave në Institutin Kombëtar të Martesës në Branson, Missouri.

Sigurimi i një Familjeje

PËR TË RRITURIT QË




Pastorët kanë një mundësi unike për të tërhequr dhe për të ndikuar pozitivisht tek të rriturit që janë beqarë. Më poshtë do të gjeni strategji specifike që pastorët mund t'i përdorin për të ndërtuar një kishë të favorshme për të rriturit që janë beqarë.

Frymërore

JANË BEQARË



Nga: DENNIS FRANCK



PËRVOJA E BARDHIT — A DO TË KTHEHET VALLË?

Bardhi mbërriti në kishë **DHJETË** minuta përpara se të fillonte shërbesa, i mbushur me shpresën që të takonte e të fliste me ndonjë person, me qëllim që të mos ndihej shumë në siklet. Kishin kaluar tre vjet që nga hera e fundit që ai kishte hyrë në një kishë. Por ndarja nga e shoqja kohët e fundit dhe procesi i divorcit e kishin ndihmuar që të kuptonte nevojën që kishte për të zhvilluar një lloj jete frymërore. Disa njerëz që po qeshnin në hyrje të kishës e vunë re, por ishin shumë të zënë me bisedat e tyre.

Dhe kështu Bardhi, pa zhurmë, gjeti një vend në rreshtin e fundit duke shpresuar që dikush do t'i fliste. Njerëzit që kishte përreth shihnin vetëm drejt, sikur të ishin të hipnotizuar ... apo ishin thjesht të frikësuar t'i flisnin dikujt që nuk e njihnin?

Filloi shërbesa: "Mirëserdhët në kishë. Le të ngrihemi të gjithë në këmbë dhe t'i këndojmë dashurisë së Perëndisë". Pas disa këngësh dhe lutjesh, drejtuesi iu kërkoi të pranishmëve që të përshëndesnin njëri-tjetrin. Bardhi u drejtua për nga personi që kishte përpara, por ai tashmë po fliste me dikë tjetër.

Pas dhjetë sekondash të sikletshëm, një burrë dhe një grua ngjitur me të e pyetën: "Jeni për herë të parë sot? A keni ardhur vetëm apo keni edhe bashkëshorten me vete?". Fjala *bashkëshorte* trazoi disa ndjenja që ishin të vështira për Bardhin. Gjithashtu, shumë pyetje po i kalonin nëpër kokë: *Pse vallë supozojnë që jam i martuar? Si ka mundësi që më bëjnë pyetje kaq personale?*

As njoftimi për kampin e ripërtëritjes frymërore për burrat e kishës nuk ndihmoi. Drejtuesi tha se i ndante vetëm një muaj nga kampi i ripërtëritjes frymërore për burrat dhe që bashkëshortet duhej të ishin të lumtura që burrat e tyre do të ktheheshin nga kampi më të pajisur për ta forcuar martesën e tyre. Brenda Bardhit vërshuan ndjenjat e vetmisë dhe të boshllëkut. Nuk ishte ai që kishte vendosur t'i jepte fund martesës; bashkëshortja e kishte lënë për një burrë tjetër.

Bardhi shpresoi që predikimi do t'i ofronte sadopak inkurajim për ta ndihmuar të përballonte procesin e divorcit. Thelbi i predikimit, që familja dhe martesë janë dëshira që Perëndia ka për ne, i shkaktoi atij dhimbje dhe përhumbje. Martesa e tij nuk ishte më.

Pastori e mbylli mesazhin e tij duke iu kërkuar çifteve dhe familjeve që të ngriheshin në këmbë për të marrë lutje. Bardhi vuri re se shumë të rritur nuk u ngritën, dhe supozoi se ata ose ishin beqarë ose atë ditë nuk kishin ardhur me bashkëshortët e tyre. Nuk u tha asgjë për personat të cilët nuk kishin bashkëshortin apo bashkëshorten me vete. Bardhi nuk e shijoi shërbesën dhe ishte në mëdyshje nëse do të kthehej përsëri.



PËRVOJA E SARËS — AJO DO TË KTHEHET

Sara kishte nisur të shkonte në kishë që kur ishte një vajzë e vogël, por tani kishin kaluar 14 vjet që nga hera e fundit. Një ndjenjë e zgjatur parehatie e bëri atë që një të diel të shkonte në kishë. Kur hyri tek dera, një burrë dhe një grua e mirëpritën: “Mirëserdhët. Unë jam Doni dhe

kjo është Maria. Po juve, si ju quajnë?”. Duke qenë vetë beqare, Sara vuri re se asnjëri prej tyre nuk kishte unazë në gisht dhe mendoi sa mirë ishte që një mashkull beqar dhe një femër beqare ishin në skuadrën e mikpritjes.

“Unë jam Sara. Sot kam ardhur për herë të parë”.

“Sa mirë”, tha Maria. “Ne takojmë shumë persona që vijnë për herë të parë dhe jemi të gëzuar që keni ardhur. A do të ishte e mundur që të uleshim edhe ne me ju?”.

“Besoj se po ... nuk më duket se ka ndonjë problem. Faleminderit”. Sarës i pëlqeu që disa njerëz që nuk i njihte, do të uleshin në kishë bashkë me të.

Doni dhe Maria arritën ta ndjejnë konfuzionin e Sarës në momente të caktuara gjatë shërbesës dhe i dhanë asaj shpjegime të shkurtra e të thjeshta se përse njerëzit emocionoheshin, ngrinin duart lart apo luteshin me zë.

“Pavarësisht nëse sapo keni ardhur në këtë zonë apo jetoni këtu, pavarësisht nëse jeni e martuar, e rimartuar, beqare apo sërish beqare, këtu jeni e mirëpritur. Jeni pjesë e familjes së Perëndisë dhe ne do bëjmë gjithçka të mundemi që t’ju ndihmojmë të ndiheni si pjesë e kësaj familjeje.”

Kjo më duket fantastike, mendoi Sara. Kam shumë nevojë të ndihem si pjesë e një familjeje, duke qenë

se familja ime është 500 km larg. Pas shërbesës, Doni dhe Maria e pyetën Sarën nëse donte të dilte për drekë me ta. “Jemi disa beqarë që mblidhemi bashkë dhe hamë drekë të dielave”, tha Doni. “Kemi pothuajse gjithmonë të rinj dhe do të na pëlqente sikur të na bashkoheshit edhe ju.”

Sa bukur, mendoi Sara, të dielave pasdite unë jam vetëm gjithsesi. “Po, do të vij. Faleminderit.” Atë ditë, Sara u takua me 15 beqarë të tjerë dhe mësoi se ata takoheshin çdo javë për të diskutuar dhe për të kaluar kohë, dhe bënë një ose dy aktivitete shoqërore çdo muaj. Ajo mendoi se ky mund të ishte një grup ku ajo mund të ndërtonte marrëdhënie të shëndetshme. E diela ishte një ditë e mirë për Sarën.

TË RRITURIT QË JANË BEQARË

Në çdo komunitet gjejmë të rritur beqarë të të gjitha moshave dhe tipave. Të marrim në konsideratë tipat e ndryshëm të të rriturve beqarë që jetojnë në lagjet tona.

- Të rritur që nuk janë martuar asnjëherë
- Të rritur të ve
- Të rritur të divorcuar
- Familje me një prind që kanë fëmijë nën moshën 18 vjeç
- Rimartesa që përziejnë fëmijët nga martesa të mëparshme

Njerëzit kanë probleme me martesën dhe me rritjen e fëmijëve; ata kacafyten me papunësinë dhe frikën; i mbyllin dyert e shtëpisë menjëherë pasi hyjnë brenda që të mos i lejojnë fqinjët të shohin brenda zemrave dhe jetëve të tyre. Shumica e tyre e kanë braktisur shpresën se jeta do të bëhet ndonjëherë më e mirë. Këta individë kanë jashtëzakonisht nevojë që të shohin dashurinë e Perëndisë përmes kishës, në qoftë se do të bëhen pjesë e familjes së kishës.

JU E BËNI NDRYSHIMIN

Kisha juaj mund ta bëjë ndryshimin duke iu shfaqur të tjerëve dashurinë e Perëndisë. Historia e Bardhit portretizon një përvojë, e cila është shumë e zakonshme në shumë kisha sot. Bardhi, duke qenë beqar, kishte nevojë të ndihej i përfshirë dhe pjesë e një familjeje.

Të krishterët duhet të sigurojnë një familje frymërore për njëri-tjetrin, veçanërisht për ata të cilët ndoshta nuk e kanë një familje për shkak të vdekjes së bashkëshortit apo bashkëshortes, të prishjes së një martese, apo për shkak se të afërmit i kanë shumë larg, ose për arsye të tjera.

Kishat duan që të gjithë njerëzit të bëhen pjesë e një kishë dhe të ndihen pjesë e saj. Megjithatë, vetëm shpresa nuk mjafton që kjo gjë të bëhet realitet.



Mendime të gabuara për beqarët — Çfarë besoni?

- * **Të rriturit që janë beqarë janë të vetmuar.** Është e vërtetë që disa janë të vetmuar, por nuk duhet të jeni beqarë për të qenë të vetmuar. Disa të martuar janë gjithashtu të vetmuar.
- * **Të rriturit që janë beqarë duan të martohen.** Disa duan të martohen. Megjithatë, shumë prej tyre janë të lumtur që janë beqarë dhe shijojnë fleksibilitetin që kanë me paratë, kohën dhe zgjedhjet që bëjnë. Më mirë do të ishte që të kërkonin për njeriun e jetës në kishë sesa në botë.
- * **Burrat beqarë janë të papërgjegjshëm.** Disa janë, disa nuk janë. Disa burra të martuar janë gjithashtu të papërgjegjshëm.
- * **Të rriturit që janë beqarë janë të tensionuar nga ana seksuale.** Për shkak të vdekjes së bashkëshortit apo bashkëshortes ose përfundimit të një martese, shumë

njerëz tani po mësojnë të jetojnë një jetë në beqari dhe abstinencë seksuale. A po i ndihmon kisha juaj këta njerëz që të përshtaten?

- * **Të rriturit që janë beqarë kanë më pak probleme se të rriturit e martuar.** Nuk është tamam ashtu. Thjesht kanë probleme të ndryshme. Edhe beqaria, edhe martesa kanë një sërë problemesh.
- * **Të rriturit që janë beqarë kanë frikë të marrin një përkushtim.** Kjo fjali përpiket të shpjegojë se përse disa njerëz nuk janë martuar. Por në themel është e pavërtetë sepse beqarët e shtynë martesën për një mori arsyesh.
- * **Të rriturit që janë beqarë kanë më shumë kohë sesa të rriturit e martuar.** Përsëri e pavërtetë. Beqarët kanë të njëjtat detyra shtëpie, por pa një bashkëshort apo bashkëshorte që t'i ndihmojë.
- * **Të rriturit që janë beqarë janë një kërcënim për të rriturit e martuar.** Kjo pothuajse gjithmonë është e pajustificuar. Zakonisht, kështu ndihet një i martuar, dhe si rrjedhojë, mund ta largojë tutje personin që është beqar.
- * **Të rriturit që janë beqarë nuk janë të plotësuar deri kur të martohen.** Për shkak të theksit tek martesa dhe familja, beqarët ndihen si gjysmë personi. Martesa nuk plotëson (mbush) askënd. "Ju jeni të mbushur në të" (Kolozianëve 2:101).
- * **Të rriturit që janë beqarë kanë më shumë para sesa të rriturit e martuar.** Vetëm disa kanë të ardhura të mira. Të sapo-diplomuarit nuk kanë hyrë ende në fazën që prodhojnë të ardhura. Gratë e divorcuara shpeshherë përjetojnë humbje të të ardhurave; prindërit beqarë mezi ia dalin. Shumë të rritur të vejëruar jetojnë me të ardhura fikse e të ulëta.

DENNIS FRANCK

Beqarët e rritur në moshë kanë nevojë për një kishë që e kupton se jo të gjithë të rriturit janë të martuar, dhe jo të gjithë e kanë familjen afër. Kisha duhet të kuptojë se të rriturit që janë beqarë duan që njerëzit t'i pranojnë, madje edhe më shumë se sa ata që janë të martuar, të cilët kanë njëri-tjetrin. Kisha duhet ta dijë se të rriturit beqarë përfitojnë kur takojnë beqarë të tjerë, me të cilët kanë interesa dhe nevoja të përbashkëta. Të pamartuarit përfitojnë nga udhëheqja e asaj kishe që përdor gjuhë gjithëpërfshirëse, që i njehtë dhe i pranon individët që përfaqësojnë tipat e shumtë të gjendjes civile: të martuar, të rimartuar, beqarë, ish-të-martuar, të ndarë, prindër beqarë, etj.

Si mund t'i ndihmojë kisha juaj, që është duart, këmbët dhe zëri i Krishtit, të rriturit beqarë që të ndihen si pjesë e kishës? Si mund t'i ndihmojë bashkësia juaj që ata të vijnë në njohjen e të vërtetës së ungjillit?

SUGJERIME PËR KËDO

Këto janë disa sugjerime bazë:

- Përdorni në ekipin e mikpritjes beqarë dhe të martuar. Beqarët, në fillim të përvojës së tyre në një kishë, meritojnë një mirëseardhje të ngrohtë nga beqarë të tjerë.
- Mos e merrni të mirëqenë që personi është i martuar. Ardhja vetëm nuk do të thotë domosdoshmërisht se personi e ka një bashkëshort apo bashkëshorte; po ashtu edhe ardhja me dikë të gjinisë tjetër nuk do të thotë se ata duhet të jenë patjetër çift.
- Tregoni interes për të tjerët duke i pyetur për jetën, punën, interesat, familjen e tyre, etj. Nëse duket se kanë ardhur vetëm, pyetini nëse mund të uleni me ta. Nëse janë beqarë, prezantojini me beqarë të tjerë në kishën tuaj. Të pamartuarit kërkojnë miqësi të shëndosha.



Merrni në konsideratë këto sugjerime:

- I rezistoni tundimit për të dyshuar se një i rritur beqar dëshiron bashkëshortin apo bashkëshorten tuaj. Të rriturit e pamartuar duan dhe kanë nevojë të shohin martesë të shëndetshme.
- Mos u sugjeroni kandidatë për martesë beqarëve. Dhe as mos bëni pyetje të llojit: “Si ka mundësi që një person i talentuar si ju të jetë akoma beqar?”.
- Lutuni për të rriturit që janë beqarë dhe u thoni se po luteni për ta.
- Refuzojini idetë e rreme sipas të cilave: beqarët kanë më pak probleme, beqarët vijnë vërdallë për të gjetur nuse ose burrë, beqarët janë të vetmuar, beqarët janë të pasur, etj.
- Ndhijmohini prindërit që janë beqarë me rregullime në shtëpi, me përkujdesje për fëmijët, duke i vizituar kur janë në spital, etj. Kjo iu tregon atyre se të martuarit përkujdesen për ta.
- Ftojini beqarët në shtëpinë tuaj gjatë festave.

SUGJERIME PËR PASTORËT

- Mos e merrni të mirëqenë që personi që vjen është i mësuar me adhurimin dhe stilin e kishës suaj. Shpjegoni pjesët e shërbesës të cilat mund të jenë frikësuese për vizitorët.
- E ftoni për drekë personin e pamartuar që ishte për herë të parë në shërbesë. Merrni edhe beqarë të tjerë me të cilët ai ose ajo mund të ndërtojë marrëdhënie.

SUGJERIME PËR TË RRITURIT E MARTUAR

Në shumë kisha, familjet kanë prirjen që të lidhen mirë me njëra-tjetrën, ndërsa lidhja midis të rriturve beqarë dhe atyre të martuar zakonisht është e dobët, apo madje edhe inekzistente. Përkushtohuni për të ndërtuar ura mbi hendekun që ekziston midis të rriturve të martuar dhe atyre beqarë.

- Pastorët kanë një mundësi unike për të tërhequr të rriturit që janë beqarë dhe për të ndikuar pozitivisht tek ata. Më poshtë do të gjeni strategji specifike që pastorët mund t'i përdorin për të ndërtuar një kishë të favorshme për të rriturit që janë beqarë:
- Gjeni të rritur beqarë që të japin dëshmi se si i ka ndihmuar kisha ose Zoti.
- I inkurajoni beqarët që të shërbejnë në të gjitha shërbesat që ofron kisha. Pali thotë tek letra 1 Kor.7:9 se ai ishte beqar (të paktën për një pjesë të shërbesës së tij). Tek vargjet 26-35, ai shpjegon se në fakt është më mirë të jemi beqarë për shërbesën, për shkak se kjo na lejon më tepër fleksibilitet të kohës dhe të burimeve, sesa lejon martesë. Një personi që është beqar nuk i duhet të bjerë dakord me bashkëshortin për të dhënë të dhjetën, për të dhënë për misionin, për të shkuar në udhëtime misioni, për të dhënë mësim, etj.

- Vërimi të martuarit dhe beqarët që të luten për njëri-tjetrin dhe theksoni faktin se Jezusi ishte beqari më i famshëm që ka jetuar ndonjëherë.

Këto veprime do t'i ndihmojnë jashtë mase beqarët për t'u ndier të përfshirë në kishat e përqendruara tek familja dhe do t'i ndihmojnë që të bëhen pjesë e familjes së Perëndisë.

FORMONI GRUPE SPECIFIKE

Çdo kishë ka disa beqarë. Kush janë ata? Sa janë? Në ç'moshë janë dhe kush është statusi i tyre i beqarit? Ndoshta kisha mund ta ketë tashmë një bazë të dhënash me këtë informacion. Nëse jo, atëherë një anketim i shkurtër me shkrim, që mund të plotësohet në kohën e shërbesës kryesore, do t'i identifikojë shumë shpejt të gjithë të rriturit për sa i përket moshës së secilit, gjendjes civile, numrit, moshave të fëmijëve të tyre, etj. Ky informacion do të ndikojë që të vendosni cilin prej tyre të keni si objektiv të ardhshëm, si edhe do t'i shërbejë shërbesave të tjera.

Disa kisha i kanë burimet e mjaftueshme për të filluar një shërbesë me objektiv beqarët e një grup-moshe të caktuar (18 - 29 vjeç, 30 - 40, 40 - 60) ose të një grupi me probleme të jetës (të rriturit e vejuar, familjet me një prind, të divorcuarit, etj.). Të rriturit kanë më shumë gjëra të përbashkëta me të tjerët që janë nga grup-mosha të ngjashme ose që kanë probleme të ngjashme të jetës. Jo të gjitha kishat do të zgjedhin që të fillojnë një shërbesë specifike për beqarët. Megjithatë, shumica e kishave mund të ndihmojë në përmbushjen e disa prej nevojave frymërore, shoqërore, arsimore dhe nevojave për marrëdhënie që kanë të pamartuarit. Shumë prej tyre mund të fillojnë duke planifikuar disa shërbesa të specializuara për ta. Një ose më shumë nga këto aktivitete do të tërheqë interesin e beqarëve.

- Një mësim i përjavshëm dhe një grup diskutimi që mbledhet çdo javë
- Një aktivitet i përmuajshëm social
- Një seminar një herë në tre muaj
- Një ndihmë në komunitet çdo 6 muaj
- Një kohë e përvitshme rifreskimi apo ripërtëritjeje frymërore

MË E PAKTA QË MUND TË BËJË NJË KISHË

Nëse do të kuptojmë dhe do të përdorim katër parimet si më poshtë, atëherë do t'i ndihmojmë beqarët të ndihen si pjesë e familjes së kishës. Gjithashtu, kjo do t'iu japë pranim, inkurajim dhe vlera individëve që nuk janë martuar kurrë, të divorcuarve, atyre që janë të vejëruar dhe prindërve beqarë, të cilët zakonisht përbëjnë 30 deri në 50 për qind të të rriturve në çdo kishë.

Shprehni pranim për të rriturit që janë beqarë gjatë mësimit dhe predikimit. Fjali si këto në vijim iu japin një vlerësim të veçantë të rriturve që janë beqarë. "Pavarësisht nëse jeni të martuar, të rimartuar, të pamartuar apo beqarë, në kishën tonë ka vend për ju. Jezusi jetoi një jetë me efikasitet ndërkohë që ishte beqar, dhe ne dëshirojmë t'ju ndihmojmë që edhe ju të bëni po kështu."

Jepni shembuj me beqarë nga Shkrimi. Jezusi, Pali (1 Korintasve 7:8), Gjon Pagëzori dhe Jeremia ishin të pamartuar. Ezekieli ishte i ve. Maria, Marta, Ana, gruaja samaritane, Maria Magdalena, Agari, Dina, Miriami, Naomi dhe Vashti ishin të pamartuara ose ishin kthyer sërish beqare.

Ofroni mbështetje dhe ndihmë materiale dhe financiare për familjet me një prind. Disa mënyra të shkëlqyera për të treguar dashurinë e Krishtit mund të jenë: ndërrimi falas i vajit të makinës, riparime të makinës ose të shtëpisë, përkujdesje falas për fëmijët në raste të veçanta, ndihmë financiare e herë pashershme, një festë Krishtlindjeje me dhurata, etj.

Lejojini të rriturit beqarë që të marrin pjesë në shërbesa vetëm për beqarët në një kishë tjetër, ndërkohë që ata e mbështesin kishën tuaj si kishën e tyre. Përafërsisht 20 për qind e të gjitha kishave kanë një shërbesë për beqarët. Shumë nga këta beqarë marrin pjesë në një shërbesë vetëm për beqarë në një kishë tjetër, ndërkohë që vazhdojnë të mbështesin kishën e tyre. Këto shërbesa vetëm për beqarë që frekuentohen nga beqarë nga kisha të tjera duhet ta bëjnë rregullisht të qartë se: "Ne nuk po përpiqemi t'ju bëjmë pjesë të kishës sonë. Nëse jeni pjesë e një kishë tjetër, ju lutem mbështeteni kishën tuaj këtë fundjavë me lutjet tuaja, përfshirjen dhe ofrimet tuaja". Frymëzoheni kishën tuaj që të arrijë beqarët, t'iu shërbejë atyre dhe t'i ndihmojë të mësojnë se si të shërbejnë. Popullsia e beqarëve është tepër e madhe për t'u lënë pas dore, ndërsa aftësitë dhe talentet e tyre janë tepër të çmuara për t'u çuar dëm. Dhuntitë dhe krijimtaria e të rriturve beqarë, duke shërbyer në çdo fushë, mund ta bekojë kishën. Megjithatë, kisha që i shpërfill ata e nuk iu jep hapësira për të shërbyer, e dobëson të tashmen e saj dhe e lë peng të ardhmen e saj.



DENNIS FRANCK, themelues i shërbesës *Franck Insights*, është autor librash, këshillues dhe folës në denominacione, shërbesa dhe kisha të ndryshme në lidhje me shërbesën e beqarëve. Ai është ish - drejtori i Shërbesave për Të Rriturit Beqarë për Asambleenë e Perëndisë në SHBA.

SHËRBESA UNIKE

e

Nënë

Nga: MARCIA LEDNICKY



Një nënë drejton një ndërmarrje veshmbathjeje, një lavanderi, një restorant, një qendër këshillimi, një shërbim mirëmbajtjeje, një stacion taksish, një infermieri. Ajo është rojtari i kopshtit zoologjik për të gjitha kafshët që sillen në shtëpi, një gjyqtare, një gjykatëse dhe juria për t'u marrë me mosmarrëveshjet.

GRA, JU JENI FANTASTIKE!

Kur mendoni për shtëpinë, çfarë tabloje ju vjen ndër mend? A mendoni për vaktet që duhen gatuar, për enët që duhen larë, rrobat që duhen futur në lavatriçe dhe për dyshtet që duhet fshirë? Apo fjala shtëpi ju jep ndjenja dashurie, ngrohtësie dhe bashkësie familjare? Shumë gra e mendojnë të nevojshme të punojnë jashtë shtëpisë; megjithatë, nuk ekziston asnjë profesion më i mirë sesa të qenit amvisë. Ky profesion përmbush nevojat emocionale dhe ofron një mundësi të veçantë për shërbesë. Të qenit nënë është një nga profesionet më të rëndësishme dhe më shpërblyese në të gjithë botën. Dhe kërkon gjithë dashurinë, forcën dhe urtësinë që një grua mund të ketë. Një nënë drejton një ndërmarrje veshmbathjeje, një lavanderi, një restorant, një qendër këshillimi, një shërbim mirëmbajtjeje, një stacion taksish, e një infermieri. Ajo është rojtari i kopshtit zoologjik për të gjitha kafshët që sillen në shtëpi, një gjyqtare, një gjykatëse dhe juria për t'u marrë me mosmarrëveshjet. Gra, ju jeni fantastike!

Fjala nënë ose nënat përmendet në Bibël mbi 300 herë

Do të marrim një aspekt të familjes i cili ka një domethënie jetike. Për këtë aspekt jepet shpesh mësim në Shkrim. Pra, po flasim për fëmijët tanë. Fatkeqësisht, ka raste në shtëpinë e shërbëtarit kur fëmijët mund të fillojnë të mendojnë se nuk janë të rëndësishëm, për shkak se prindërit e tyre janë kaq të zënë duke u kujdesur për nevojat e të tjerëve sa që nuk arrijnë të dallojnë që vetë fëmijët e tyre kanë nevojë për dashuri dhe vëmendje personale.

Çfarë mund të bëj unë për t'u siguruar që fëmija im do ta dojë Perëndinë dhe shërbesën në të cilën Ai na ka thirrur? Pavarësisht se sa shumë të detyruara ndiheni për të shërbyer në kishë, mos i anashkaloni nevojat e familjes suaj. Fëmijët tuaj kanë nevojë për një nënë të mirë më shumë seç ka nevojë kisha për një punëtorë tjetër. Kjo është detyra që ju është caktuar nga Perëndia. Në qoftë se pastori dhe familja e tij po e jetojnë jetën si familje në pështjellim, atëherë puna e kishës nuk do të përparojë aq mirë. Dashuria e singertë ofrohet së pari në familje. Gjithashtu, sërish në familje fëmija fillon të ndihet se e duan ose se e duan më pak se të tjerët. Po në familje dashuria ose shprehet ose lihet në hije nga përgjegjësitë e tjera. Është sërish familja vendi ku mbillen rrënjët e thella emocionale të sigurisë apo pasigurisë, të besimit apo të dyshimit.

Le të marrim parasysh disa hapa për t'u siguruar që fëmija juaj do të ketë një dashuri për Perëndinë dhe për shërbesën e kishës.

1. JINI NJË NËNË E MIRË

- **Dashuroni me bollëk.** Dashuria e vërtetë dhe kujdesi ofrojnë një ndjenjë sigurie për fëmijët. Prindërit duhet të shfrytëzojnë çdo rast për t'i përqafuar dhe inkurajuar fëmijët e tyre. Kjo nuk ju kushton asgjë përveç kohës dhe vëmendjes. Kam një kujtim timin të cilin do ta mbaj gjallë gjithmonë. Vajza jonë e vogël, e cila tashmë është tek Jezusi, më ka thënë diçka që do ta kujtoj përgjithmonë. Shpeshherë, pa ndonjë arsye të caktuar, unë i thosha: "A e di një gjë, vogëlushe?". Dhe ajo më përgjigjej: "Çfarë?" Unë i

thosha: “Të kam për xhan”. Një ditë i thashë: “A e di një gjë, vogëlushe?”. “E di”, tha ajo. “Çfarë?”, e pyeta unë. “Më ke për xhan”, tha ajo. Për mua si nënë, ashtu si për çdo nënë që pyet veten ndonjëherë nëse po ofron një ambient të dashur shtëpie, komenti i saj ishte si ar i kulluar.

- **Kaloni kohë bashkë.** Lini një kohë çdo ditë për të kaluar një kohë cilësore me fëmijët tuaj. I mësoni fëmijëve tuaj aftësi të cilat do t’i ndihmojnë në jetë. Për shembull, gratë mund t’iu mësojnë vajzave të tyre të çmuara që të gatujnë. Me siguri që bashkëshortët e tyre të ardhshëm do t’ju falënderojnë! Megjithatë kjo iu drejtohet kryesisht nënave, edhe baballarët duhet të përfshihen për t’iu mësuar bijve se si të zhvillojnë aftësi të cilat do të kenë një vlerë të jashtëzakonshme kur të rriten. Shumë herë është më e lehtë dhe më e shpejtë që një punë të caktuar ta bëni vetë. Por, kur përfshini edhe fëmijët tuaj, jo vetëm që po iu mësoni aftësi për jetën e tyre, por gjithashtu po krijoni edhe kujtime jetëgjata. Ende më kujtohen rastet kur Mishela jonë e vogël më ndihmonte në kuzhinë kur bëja biskota. Shpërndahej miell gjithandej. Ishte shumë gallatë! Ndoshta jeni duke bërë punët tuaja të zakonshme, kur fëmija ju thotë: “O ma, shiko çfarë po bëj”, ose “hajde luajmë”, ose “a të ndihmoj edhe unë?”. Kur e përfshini fëmijën tuaj, mesazhi që po përcillni është: “Ti je shumë i vlefshëm / e vlefshme. Ia vlen që të kaloj kohë me ty. Je shumë i veçantë / e veçantë për mua. Ndjej shumë dashuri për ty.”

Gjatë jetës sime, kultura ka ndryshuar shumë. Kur isha më e re, nuk kishim as televizor në shtëpi e jo më telefona celularë. Tani ka kaq shumë gjëra që marrin kohë nga koha e familjes. Nënata duhet t’i ruajnë me kujdes ato momente që janë të disponueshme. Shumë shpejt foshnja do të fillojë të ecë, do të hyjë në shkollë, do të bëhet adoleshente, dhe më



pas do të largohet nga shtëpia për punë, arsimim apo martesë.

Si prindër, duhet t’i kujtojmë vetes që të mos e lejojmë televizorin ta dominojë kohën tonë apo që ta përdorim atë si një dado për fëmijët tanë. Shumë kohë e çmuar dhe shumë mundësi për të ndikuar tek fëmijët tanë mund të shkojnë dëm përpara se sa të kuptojmë se çfarë na ndodhi. Sot telefonat celularë janë kthyer në një frenues madhor të komunikimit midis prindërve dhe fëmijëve. Për fat të keq, për disa celulari është kthyer në një zëvendësues të marrëdhënieve personale dhe e zvogëlon aftësinë për të njohur gëzimin e shtëpisë dhe të jetës në familje.

- **Ndërtoni vetëvlerësim.** Imazhi pozitiv për veten është kaq shumë i rëndësishëm për shëndetin mendor. Ndërsa fëmijët rriten, kërkon mundësi për t’iu dhënë atyre detyra, të cilat pasi të jenë kryer, t’iu japin një kuptim më të mirë të vlerës që kanë si persona. Është e rëndësishme që fëmijëve t’iu jepen punë dhe përgjegjësi që janë të përshtatshme për moshën e tyre. Se në fund të fundit, nuk dëshironi të rrisni një fëmijë të padisiplinuar e dembel.

Ditët dhe vitet që keni në dispozicion për të investuar tek fëmijët tuaj dhe për t’i udhëhequr ata drejt përdishmërisë do të kalojnë shumë shpejt. Llogariteni çdo ditë si një bekim të veçantë dhe si një mundësi unike, të dhënë nga Perëndia, për të përmbushur detyrën e rritjes së fëmijëve tuaj.

2. BËJENI SHTËPINË NJË VEND TË LUMTUR

Një tjetër pjesë e të qenit një nënë e mirë është që ta bëni shtëpinë tuaj një vend të lumtur e të paqtë.

- **Bëhuni komiteti i pritjes për fëmijën tuaj kur të vijë në shtëpi nga shkolla.** Unë kam shumë kujtime të bukura nga koha kur isha e vogël dhe vija nga shkolla dhe gjeja nënën që më priste tek dera. Mezi prisja t’i tregoja gjithçka që kisha bërë atë ditë në shkollë. Isha e sigurt, në mendjen time, se edhe ajo mezi priste që unë të kthehesha në shtëpi që të dëgjonte se si kishte shkuar dita ime. Kisha nënën më të mirë që mund të ketë ndonjë vajzë. Por kjo nuk filloi kur isha adoleshente. Filloi që në ditën e parë të shkollës. Si rrjedhojë, kur u bëra adoleshente, nuk u ndjeva kurrë sikur nëna nuk më besonte ose sikur po i “fuste shumë hundët” në jetën time. Sepse, kështu kishte qenë që kur isha një vajzë e vogël. Nëna ishte një shoqe shumë e mirë dhe njeriu që i besoja më shumë.

- **Hani rregullisht vakte si familje sa më shumë të jetë e mundur.** Padyshim, koha e ngrënies duhet të jetë një kohë e lumtur dhe jo një kohë për të nxjerrë tema të pakëndshme apo ankesa. Fëmijët

duhet të mësohen të presin që koha rreth e rrotull tavolinës si familje të jetë një kohë e këndshme dhe e gëzueshme. Është e vërtetuar se kur gjërat janë të qeta, ushqimi do të tretet më mirë.

- **Dashuria, respekti dhe besnikëria midis bashkëshortëve ofron një ndjenjë sigurie për familjen.** Grindjet dhe sherret midis bashkëshortëve u sjellin fëmijëve shqetësime. Një nga frikërat më të mëdha që ka fëmija, është divorci i prindërve të tij ose të saj. Kemi një mik, i cili pati një mosmarrëveshje të fortë me bashkëshorten e tij ndërkohë që ndodheshin në makinë, dhe një nga fëmijët e tyre, u përkul para dhe pyeti: “Si shkruhet fjala ‘divorc’?”. Edhe pse çdo çift ka sfida, fëmijët duhet të marrin siguri në veçanti nga prindërit, me anë të dashurisë të cilën e shohin në jetën e përditshme familjare. Dashuria duhet të jetë edhe me fjalë, edhe me vepra miratuese.

3. PËRPIQUNI PËR NJË JETË NORMALE

- **Kërkojuni fëmijëve që t’iu binden rregullave.** Të qenit fëmija i shërbestarit, të lejon gjithmonë disa avantazhe unike, por, për hir të tyre, të njëjtat rregulla duhet të aplikohen për të gjithë, sa më shumë që të jetë e mundur. Jini të kujdesshme për të mos i shtyrë fëmijët tuaj të ecin më shumë se të tjerët, ose të mos ngulni këmbë që ata të kenë privilegje të veçanta. Po ashtu, mos i pengoni të ecin përpara vetëm nga fakti se janë fëmijët e shërbestarit. Nëse ata kanë dhunti të veçanta, prej Perëndisë, përdorini ato dhunti njësoj siç do të bënit me çdo fëmijë tjetër.

Disiplinoni në mënyrë ndërtuese. Po, hera herës fëmijët e shërbestarëve do të kenë nevojë për disiplinë. Mos harroni se ata janë në proces e sipër për t’u zhvilluar fizikisht, mendërisht, emocionalisht dhe nga ana frymërore.

Disiplina juaj le të jetë e qëndrueshme. Gjithmonë kërkon mënyra për ta mbuluar me dashuri çdo disiplinim të nevojshëm. A nuk jemi ne shumë falënderues që Atit tonë qiellor nuk i mbaron dashuria për ne edhe pse nuk i bëjmë gjithmonë gjërat siç duhet?

Është e rëndësishme që fëmijët të jenë vënë në dijeni të rregullave që më parë, në vend që t’i njoftoni në kohën e disiplinimit. Fëmijët duhet të jenë shumë të qartë për sjelljen që pritët prej tyre. Faktikisht, fëmijët duan dhe kanë nevojë për direktiva që t’i zbatojnë. Kjo gjithashtu iu jep atyre një ndjenjë sigurie, duke e ditur që dikush i do aq shumë sa që vendos kufij për sjelljen. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që fëmijët të korrigjohen atëherë kur me vetëdije nuk janë bindur; megjithatë, mos i

turpëroni dhe mos i poshtëroni duke i dënuar haptazi në një ambient publik. Dhënia e disiplinës përpara të tjerëve jo vetëm që e turpëron fëmijën tuaj, por gjithashtu edhe njerëzit që janë aty rrotull. Kur ndëshkimi është i nevojshëm, shpjegojani arsyet fëmijës. Mos përdorni justifikimet që jeni të lodhur apo të zemëruar. Mos e lejoni asnjëherë fëmijën “t’jua prishë mendjen” në lidhje me një ndëshkim që ju mendoni se është i domosdoshëm. Ashtu siç thotë edhe Fjala e Perëndisë, ju si prindër, duhet ta trajtoni fëmijën që të respektojë prindërit e tij / saj dhe ta mësoni të respektojë dhe t’i bindet Perëndisë (Fjalët e Urta 22:6).

- **Jini të arsyeshme, mirëkuptuese dhe fleksibël kur merreni me fëmijët.** Jini të qëndrueshme me kushtet që keni vendosur në lidhje me çështjet madhore të jetës, siç është pastërtia seksuale. Jini më fleksibël kur vjen puna për çështjet e vogla, si orari i gjumit. Fëmijët do t’i respektojnë ata prindër që kujdesen aq sa të vendosin kufij dhe, në mënyrë të kujdesshme e të dashur, i përforcojnë ato. Direktivat e sjelljes duhet të rakordohen nga të dy prindërit, dhe asnjëri prej tyre nuk duhet t’i prishë rregullat e vendosura së bashku.



• **Mos u thoni kurrë atyre se duhet të sillen në një mënyrë të caktuar për shkak se janë fëmijët e shërbestarit.** Ne rrënjosim te fëmijët tanë dëshirën për të jetuar në atë mënyrë që të jetë e pëlqyer për Krishtin. Kur e duam dikë, duam edhe që ta kënaqim atë. Ndhimoheni fëmijën tuaj, që në një moshë sa më të hershme, të kuptojë se Krishti vdiq për të, dhe se Ai dëshiron që ai / ajo ta pranojë Atë si shpëtimtarin e tij/saj personal. Është një privilegj i gëzueshëm t'i shërbesh Krishtit, dhe marrëdhënia me Të nuk është një marrëdhënie frike dhe as një përpjekje për të përmbushur pritshmëritë e të tjerëve. Nëse fëmijët besojnë se ajo që mund të bëjnë ose nuk mund të bëjnë është për shkak të kishës dhe thirrjes që prindi i tyre ka në shërbesë, atëherë ndërsa rriten, do ta kenë zët kishën dhe shërbesën. Shtëpia është vendi ku mësohen vlerat e përjetshme. Një fëmijë duhet të ketë vlera frymërore Biblike që të udhëheqin jetën e tij / saj.

• **Mësojini fëmijët të kenë respekt për ju dhe për njëri-tjetrin.** Do të ketë raste kur ne si prindër bëjmë vendime të gabuara ose sillemi në mënyrë të papërshtatshme. Nuk është shenjë dobësie nëse kërkojmë të falur kur e kemi gabim. Duhet të jemi të sjellshme me fëmijët tanë. Në fund të fundit, ata janë krijimi i Perëndisë. Duke i trajtuar me respekt, ne po iu mësojmë atyre të tregojnë respekt. Si prind, duhet të këmbëngulni që fëmijët tuaj t'ju trajtojnë me respekt. Nuk po u tregojmë dashuri kur i lejojmë fëmijët të abuzojnë me fjalë me më të mëdhenjtë. Në fakt, ashtu si njëri nga prindërit trajton tjetrin, po ashtu do të bëjnë edhe fëmijët.

Nëse burri juaj ju trajton me respekt, atëherë ai, me anë të shembullit të tij, po iu mëson fëmijëve ta respektojnë nënën e tyre. Dhe ndërsa ju e trajtoni burrin tuaj me respekt, edhe ju po i mësoni fëmijët, me anë të shembullit tuaj, ta respektojnë atin e tyre tokësor. Deri ditën kur Zoti i mori pranë Tij prindërit e mi, të cilët ishin shërbestarë për më shumë se 60 vite, unë i kam trajtuar me respektin më të madh. Këtë na kishin mësuar në shtëpinë tonë, dhe këtë shembull kishim parë. Përtej shumë përfitimeve sociale, respekti për prindin është një parim i Fjalës së Perëndisë (Eksodi 20:12, Efesianëve 6:1-3).

4. DUAJENI KISHËN

Ja si i ndihmoni ju fëmijët tuaj që ta duan kishën:

• **Duke dhënë shembullin e dashurisë që keni për Perëndinë dhe shtëpinë e Tij.** Shkoni rregullisht në kishë dhe shkoni me ngazëllim dhe emocion. Adhurojeni Perëndinë haptazi dhe me çiltërsi. Tregojuni fëmijëve tuaj rreth pranisë së Perëndisë në jetën tuaj, ndërsa bashkoheni me besimtarë të tjerë për adhurim dhe miqësi.

• **Duke demonstruar përfitimet e të shkuarit në kishë në jetën tuaj.** Kur ne e jetojmë në shtëpi përjetimin e adhurimit në kishë, kjo i jep më shumë zë vlerës që ka pjesëmarrja e shpeshtë në shtëpinë e Zotit. Nëse në shtëpi jemi grindavece, imponuese dhe përgjithësisht aspak si Krishti, atëherë jemi duke ndërtuar një mur, të cilin fëmijëve tanë iu duhet ta kapërcejnë me qëllim që të kenë një dashuri personale për Perëndinë dhe për shërbesën e kishës. Atë

SHTËPIA JUAJ PO PËRGJOHET

Po, shtëpia juaj po përgjohet. Në çdo shtëpi ekzistojnë dy mikrofona për çdo fëmijë – një në secilin vesh. Këto instrumente tepër të ndjeshme arrijnë të kapin lutjet në tavolinë, himnet që këndohen, bisedat e zakonshme, komentet e rastësishme, llojet e gjuhës, një larmi fjalësh dhe fuqitë e tingullit. Këta mikrofona tejet thithës, e përcjellin atë që dëgjojnë tek disa mendje tepër të ndikueshme. Këto tinguj më pas bëhen fjalori i fëmijës dhe bazat e tij për veprim dhe reagim.

që e dëgjojnë, fëmijëve iu duhet që edhe ta shohin me vepra. Hipokrizia është shumë e dëmshme për besimin e një fëmije. Nëse ekziston një ndryshim i madh midis mënyrës se si prindërit e tyre sillen në kishë dhe mënyrës se si sillen në shtëpi, atëherë realiteti i dëshmisë së tyre do të vihet në pikëpyetje shumë shpejt nga fëmijët e tyre.

• **Duke mos folur keq për drejtuesit e kishës ose për besimtarë të tjerë në sy të fëmijëve tuaj.**

Nëse në shtëpi fëmijët do të dëgjojnë komente me ironi rreth anëtarëve të bashkësisë dhe ankesa rreth pleqve dhe drejtuesve të tjerë, atëherë ata shumë shpejt do ta humbasin besimin tek këta njerëz. Mos harroni, fëmijët i kanë veshët "pipëz" dhe ndikohen jashtëzakonisht shumë nga bisedat dhe deklaratat tona. Nëse do t'ju dëgjojnë tek flisni për dikë në kishë që nuk është treguar e mirë me ju, ata kanë tendencën t'ia hedhin fajin kishës dhe Perëndisë. Fëmijët nuk mund t'i përpunojnë problemet në të njëjtën mënyrë si të rriturit. Kur ata shohin hidhërim tek prindërit e tyre, atëherë hidhërimi do të zhvillohet brenda tyre. Hidhërimi duhet të konsiderohet si një sëmundje ngjitëse. Në vend të kritikave, nxirrni në pah cilësitë e mira të njerëzve.

• **Duke treguar se jeni të shqetësuar për mirëqenien e bashkësisë.**

Kur dikush merr shtëpinë tuaj në telefon për të kërkuar lutje, dhe ju i thoni se do të luteni, atëherë lutuni. Dhembshuria dhe dashuria për të tjerët, veçanërisht për njerëzit në nevojë, ishin cilësi të cilat Jezusi i shfaqti shpesh gjatë shërbesës së Tij në tokë. Po, ka raste kur kjo nuk është e leverdisshme. Por, duke iu treguar fëmijëve tuaj se kjo është një mundësi për t'u bërë si Jezusi, në vend që të ankoheni për ndërprerjet e shpeshta, ju do t'i edukoni ata me një ndjenjë kujdesi në zemrat e tyre.

5. FLISNI SHPESH PËR PRIVILEGJET E TË QENIT NË SHTËPINË E NJË SHËRBBESTARI

• **Iu komunikoni fëmijëve tuaj se sa bekim dhe privilegj është që të jemi shërbëtarë të Ungjillit të Krishtit.** Kjo nuk do të thotë se jemi më të mirë se të tjerët; përkundrazi, jemi të zgjedhur nga Perëndia për një vend të veçantë shërbimi. I vini theksin faktit se Ati qiellor na ka besuar që të jemi përfaqësuesit e Tij në këtë tokë.

*Nëse një fëmijë jeton me kritikizmin,
ai mëson të dënojë.*

*Nëse një fëmijë jeton me armiqësinë,
ai mëson të luftojë.*

*Nëse një fëmijë jeton me talljen,
ai mëson të jetë i turpshëm.*

*Nëse një fëmijë jeton me turpin,
ai mëson të ndihet fajtor.*

*Nëse një fëmijë jeton me tolerancën,
ai mëson të jetë i duruar.*

*Nëse një fëmijë jeton me
inkurajimin, ai mëson të ketë
besim e siguri.*

*Nëse një fëmijë jeton me lavdërimin,
ai mëson si të çmojë.*

*Nëse një fëmijë jeton me paanësinë,
ai mëson drejtësi.*

*Nëse një fëmijë jeton me sigurinë,
ai mëson të ketë besim.*

*Nëse një fëmijë jeton me aprovimin,
ai mëson të pëlqejë vetveten.*

*Nëse një fëmijë jeton me pranimin
dhe miqësinë,
ai mëson të gjejë dashuri në botë.*

• **Thelbi është të kuptojmë se të gjithë jemi qenie frymërore.** Sipas Shkrimit (L. i Përtërirë 6:1-9), shtëpia duhet të jetë vendi i parë për "ungjillëzimin". Dhe, fëmijët tuaj duhet të jenë prioriteti juaj i parë në "dëshminë" tuaj, me anë të shembullit që jepni në jetë dhe me anë të dëshmisë. Një nga pyetjet më serioze që çdo shërbëtar duhet t'i bëjë vetes është kjo: "Po sikur të fitoj mijëra njerëz për Krishtin, por vetë fëmijët e mi të humbasin përjetë?". Kur arrini të tjerët, jini të kujdesshme që të mos anashkaloni apo neglizhoni fëmijët që Ai ka vendosur në shtëpinë tuaj.

Dëshiroj ta përmbyll këtë artikull me një fjali të thjeshtë. *Një nga dhuratat më të mira që prindërit mund t'iu japin fëmijëve të tyre është dashuria për Perëndinë dhe për njëri-tjetrin.* Nëna, ju e vendosni se si do të jetë atmosfera në shtëpinë tuaj. Ju jeni kaq të veçanta, kaq të nevojshme, dhe jeni vendosur aty për qëllimin e Perëndisë. Një ditë fëmijët tuaj do të rriten dhe do t'ju quajnë të bekuara (Fjalët e Urta 31:28). Dhe në fund të rrugëtimit tuaj, Perëndia do t'ju thotë: "Të lumtë, shërbëtorë e mirë dhe besnike" (Mateu 25:21-23).



MARCIA LEDNICKÝ është një folëse e shpeshtë nëpër seminare dhe konferenca për femra. Ajo ka një aftësi unike për t'i lidhur sfidat e jetës së përditshme me të vërtetat e Shkrimit. Shërbesa e saj e të folurit në publik rritet me anë të talentit të saj vokale të jashtëzakonshëm përmes të cilit ajo komunikon dhe transmeton dashurinë e Krishtit.

Përvijim Predikimi: PRINDËRIMI BIBLIK

Teksti: Ligji i Përtërirë 6:6-9; 18

Nga: STEPHANIE PLAGENHOEF

Hyrje

Bibla luan një rol kyç në trajnimin e fëmijëve tanë. Bibla është standardi ynë i besimit dhe i sjelljes, dhe gjithçka brenda saj është e vërtetë, e pagabueshme dhe për t'u marrë me konsideratën më të lartë (2 Tim. 3:16; F.Urta 3:13-15).

1. Mësojuani Fjalën e Perëndisë fëmijëve tuaj. (v. 6) “Dhe këto fjalë që sot po të urdhëroj, do të mbeten në zemrën tënde.”

- Mbushini zemrat e tyre me Fjalën e Shenjtë** — Besoni tek Fjala dhe jetoni me besim.
- Mbushini mendjet e tyre me Fjalën e Perëndisë** — Studioni, lexoni, meditoni dhe diskutoni Fjalën e Zotit (Jozueu 1:8). Përgjigjuni ndaj pyetjeve të fëmijëve tuaj me përgjigje biblike, të cilat duhet të jenë të mirë-informuara. Nëse nuk i ofroni përgjigje biblike, atëherë fëmija juaj do të kërkojë tjetërkund për të marrë përgjigjet.

2. Merreni mbi vete përgjegjësinë për t'i trajnuar fëmijët tuaj. (v. 7 – 9) “... do t'ua ngulitësh... do të flasësh... do t'i lidhësh... si shirita... do t'i shkruash...”

Kryefjala e këtyre urdhërimeve jeni *ju*. Kjo përgjegjësi iu është dhënë prindërve nga Perëndia.

Fëmijët tuaj janë dishepujt që ju janë besuar. I udhëhiqni, i mësoni dhe i formoni ata.

a. **Trajnimi i fëmijëve tuaj nuk është përgjegjësia e një shkolle.**

Qëllimi i shkollës është të arsimojë mendjen, por jo që t'i japë formë një personi nga ana morale apo frymërore. Një fëmijë mesatarisht shpenzon në shkollë 1000 orë në vit, të cilat janë shumë për ta ndikuar, qoftë për mirë, qoftë për keq. Jini në dijeni të asaj që po mëson fëmija juaj, dhe mësojeni atë që të dallojë të vërtetën nga e gabuara. Mos hiqni dorë nga roli që ju është besuar duke ia kaluar sistemit shkollor atë që është detyra juaj.

b. **Trajnimi i fëmijëve tuaj nuk është përgjegjësia e kishës.**

Kisha është një vend për mësimin frymëror dhe ajo mund të *ndihmojë* në trajnimin e fëmijës suaj, por ka disa kufizime. Një fëmijë shpenzon mesatarisht vetëm 100 orë në vit në kishë. Ia mësoni fëmijës suaj të vërtetat e thella të Fjalës së Perëndisë në shtëpinë tuaj.

3. Jini të qëllimshëm rreth trajnimit që do të jepni. (v. 7 – 9) “... do t'ua ngulitësh... do të flasësh... do t'i lidhësh... si shirita... do t'i shkruash...”

Këto janë fjalë nxitëse për të ndërmarrë një veprim të qëllimshëm. Fjala “ngulit”, në hebraisht do të thotë “të mprehësh thikën”, njësoj siç bëjmë me një vegël pune. Në mënyrë që një fëmijë të zhvillojë formën e duhur morale dhe frymërore duhen vite të tëra dashurie, udhëzimi të kujdesshëm, korrigjimi dhe disiplinimi. Mendoni rreth nevojave të fëmijës suaj dhe lutuni për to, dhe më pas, punoni me qëllimin për t'i arritur ato objektiva. Jini një prind aktiv, jo pasiv (F.Urta 22:6).

4. Modelojeni besimin tuaj. (v. 18) “Do të bësh atë që është e drejtë dhe e mirë në sytë e ZOTIT.”

Ashtu si izraelitët, edhe ne duhet t'ua mësojmë fëmijëve tanë Fjalën e Perëndisë në çdo kohë dhe në çdo vend, dhe t'ua paraqesim shembullin tonë personal atyre.

a. **Bëhuni një shembull për fëmijët tuaj përmes asaj që thoni. (v. 7)**

Le të jetë fjalori juaj i pastër, pozitiv dhe i fokusuar tek Perëndia. Bëjini vetes pyetjen: “Sa kohë shpenzoj realisht duke folur me fëmijët e mi dhe duke i dëgjuar ata?” Një studim zbuloi se mesatarisht një prind shpenzon më pak se shtatë minuta në ditë në një komunikim domethënës me fëmijën e tij.

b. **Bëhuni një shembull për fëmijët tuaj përmes asaj që bëni. (v. 18)**

Bëni atë që është e drejtë dhe e mirë sipas standardeve të Perëndisë. Tregoni një shembull që ia vlen të ndiqet (Gj. 13:15). Një thënie thotë: “Veprat flasin më shumë sesa fjalët”. Ato vepra të cilat fëmijët tuaj do t'i shohin që ju jeni duke i bërë, po ato vepra do të bëjnë dhe ata.

Përmbyllja

Fëmijët janë si shigjetat. Kur një harkëtar merr një shigjetë, ai e vendos tek spangoja e harkut dhe e tërheq fort prapa. Më pas, e ngre shigjetën derisa gishti i tij i madh prek faqen e tij, pak më poshtë syrit. Sytë e tij shikojnë përgjatë drejtimit të trupit të shigjetës dhe marrin shenjë tek tabela dhe ai më pas e lëshon shigjetën. Harkëtarin nuk godet rastësisht, por me qëllim. Prindërimi është shumë i ngjashëm me këtë. Ne jemi përgjegjës për t'i udhëhequr fëmijët tanë në drejtimin e duhur dhe t'i lëshojmë ata me një valë energjie në mënyrë që të jenë në gjendje ta godasin shënjestrën që Perëndia ka ndërmend për ta.

Kampi Veror i Krishterë

2016

Por kujto Krijuesin tënd në ditët e rinisë sate

Predikuesi 12:1

KUSH?

ADOLESHENTE MOSHA 13-18 VJEÇ

KUR?

5-9 SHTATORI

KU?

KOMPLEKSI EDEN PARK- TIRANA

PSE?

PER TE NJOHUR ME SHUME
JEZUSIN



**Këshilli i Përgjithshëm
Asambleja e Perëndisë në Shqipëri
KONFERENCA E TË RINJVE III**

**MISION
PER
BALLKANIN**



Jacob & Julie Bock

Misionarë të Asamblesë së Perëndisë në Amerikë
Prej 31 vjetësh , Misionarë në Spanjë,
Madrid, që nga viti 1985

"Shko,
sepse ai
është
vegla që
Unë kam
zgjedhur
për ta
sjellë
emrin
Tim..."

Veprat 9:1

**03-05 Qershor 2016
Durrës Albania**

Foto: Durrës, Albania